



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 29 shtator 2026

Nr .ref.: AGJ3218/26

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KO256/26 dhe KO258/26

Parashtrues të kërkesës

KO256/26, Arian Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Parashtrues të kërkesës

KO258/26 Arian Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Vendimit nr. 11-V-002, të 9 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit; Vendimit procedural të 11 shtatorit 2026 për mënyrën e votimit të nënkryetarëve; dhe konstatimit të 13 shtatorit 2026 për konstituimin e legjislaturës XI të Kuvendit të Republikës së Kosovës”

dhe

Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Vendimit Nr. 11-V-007, të 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës”

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi - Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa KO256/26 është dorëzuar nga Arian Tahiri, Përparim Gruda, Mergim Lushtaku, Fadil Demaku, Eman Rrahmani, Elmi Reçica, Besa Kabashi-Ramaj, Eliza Hoxha, Rustem Mustafa dhe Rrahman Rama, deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) nga Partia Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK), të cilët i përfaqëson Faton Fetahu, avokat në Prishtinë.
2. Kërkesa KO258/26 është dorëzuar nga Arian Tahiri, Përparim Gruda, Mergim Lushtaku, Ariana Musliu-Shoshi, Fadil Demaku, Rrahman Rama, Artan Behrami, Eman Rrahmani, Elmi Reçica, Besa Kabashi-Ramaj dhe Eliza Hoxha, deputetë të zgjedhur të Kuvendit nga PDK-ja, të cilët i përfaqëson Faton Fetahu, avokat në Prishtinë (në tekstin e mëtejme, të referuar bashkërisht si: parashtruesit e kërkesave).

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesave kontestojnë kushtetutshmërinë e “Vendimit nr. 11-V-002, të 9 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit; Vendimit procedural të 11 shtatorit 2026 për mënyrën e votimit të nënkryetarëve; dhe konstatimit të 13 shtatorit 2026 për konstituimin e legjislaturës XI të Kuvendit”, si dhe të “Vendimit Nr. 11-V-007, të 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës”.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës KO256/26 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së “Vendimit nr. 11-V-002, të 9 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit; Vendimit procedural të 11 shtatorit 2026 për mënyrën e votimit të nënkryetarëve; dhe konstatimit të 13 shtatorit 2026 për konstituimin e legjislaturës XI të Kuvendit” në raport me nenin 4 [Forma e Qeverisjes], nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve], nenin 74 [Ushtrimi i Funkcionit], nenin 76 [Rregullorja e Punës], nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me “Kreun IV të Rregullores së Kuvendit dhe jurisprudencën e Gjykatës në rastet KO124/25, KO193/25 dhe KO196/25, KO265/25, KO325/25, si dhe, për qëllime të masës së përkohshme, KO72/26 dhe KO74/26.”
5. Objekt i çështjes së kërkesës KO258/26 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së “Vendimit Nr. 11-V-007, të 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës”, në raport me nenet 4 [Forma e Qeverisjes], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 66 [Zgjedhja dhe Mandati], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve], 74 [Ushtrimi i Funkcionit], 92 [Parimet e Përgjithshme], 93 [Kompetencat e Qeverisë], 95 [Zgjedhja e Qeverisë], 112 [Parimet e Përgjithshme] dhe 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës.
6. Parashtruesit e kërkesës KO256/26 po ashtu kërkojnë nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme, me arsyetimin se “duke qenë se kërkesa e tanishme përfshin jo vetëm vendime konkrete, por edhe një vendim procedural të materializuar në transkript dhe një konstatim me pasoja për statusin e tërë Kuvendit, parashtruesit kërkojnë edhe masë të shprehur në mënyrë që objekti dhe shtrirja e pezullimit të jenë të qarta dhe të mos krijohet pasiguri e mëtejshme institucionale” përkatësisht, kërkojnë nga Gjykata që të pezullohen “efektet juridike që varen nga konstatimi i kontestuar i konstituimit, përfshirë rrjedhjen

dhe zhvillimin e procedurës kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit, deri në vendimin përfundimtar”.

Baza juridike

7. Kërkesat janë parashtruar bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr.01/2023 të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 14 shtator 2026, fillimisht, tetëmbëdhjetë (18) deputetë të PDK-së dorëzuan kërkesën KO256/26 në Gjykatë, të nënshkruar nga deputetët në vijim: Arian Tahiri, Arben Mustafa, Ariana Musliu-Shoshi, Artan Behrami, Bedri Hamza, Besa Kabashi-Ramaj, Blerta Deliu-Kodra, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Enver Hoxhaj, Fadil Demaku, Ganimete Musliu, Jakup Nura, Mergim Lushtaku, Perparim Gruda, Rustem Mustafa, Uran Ismaili dhe Vlora Çitaku.
9. Më 14 shtator 2026, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KO256/26] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO256/26] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Bajram Ljatifi dhe Enver Peci (anëtarë).
10. Më 15 shtator 2026, dhjetë (10) deputetë të PDK-së dorëzuan kërkesën KO258/26 në Gjykatë, të nënshkruar nga deputetët në vijim: Arian Tahiri, Perparim Gruda, Mergim Lushtaku, Fadil Demaku, Eman Rrahmani, Elmi Reçica, Besa Kabashi-Ramaj, Rustem Mustafa, Rahman Rama dhe Eliza Hoxha. Sipas autorizimit për përfaqësim të dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës KO258/26, njëmbëdhjetë (11) deputetë dorëzuan autorizimin e tyre për përfaqësim, përkatësisht deputetët: Arian Tahiri, Perparim Gruda, Mergim Lushtaku, Ariana Musliu-Shoshi, Fadil Demaku, Rahman Rama, Artan Behrami, Eman Rrahmani, Elmi Reçica, Besa Kabashi-Ramaj dhe Eliza Hoxha.
11. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, në pajtim me paragrafin 3 të rregullit 32 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] të Rregullores së punës, përmes Urdhrit [Urdh. KO256/26 dhe KO258/26], urdhëroi bashkimin e kërkesës KO258/26 me kërkesën KO256/26. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit të lartcekur, për kërkesat e bashkuara, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues mbetet në përbërje të njëjtë, siç është përcaktuar për kërkesën e parë, përkatësisht kërkesën KO256/26.
12. Më 15 shtator 2026, parashtruesit e kërkesës KO256/26, përkatësisht dhjetë (10) deputetët si në vijim: Arian Tahiri, Perparim Gruda, Mergim Lushtaku, Fadil Demaku, Eman Rrahmani, Elmi Reçica, Besa Kabashi-Ramaj, Eliza Hoxha, Rustem Mustafa dhe Rahman Rama dorëzuan autorizimin për përfaqësim të tyre nga z. Faton Fetahu. Rrjedhimisht, sipas autorizimit për përfaqësim të dorëzuar, parashtrues të kërkesës janë dhjetë (10) deputetë.

13. Më 15 shtator 2026, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesave dhe për Urdhrin për bashkimin e tyre: (i) parashtuesit e kërkesave; (ii) Ushtruesen e Detyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: U.d Presidentja), e cila u njoftua edhe për mundësinë e dhënies së komenteve; (iii) Kryeministrin e Republikës së Kosovës, i cili u njoftua për mundësinë e dhënies së komenteve; (iv) Zëvendës Sekretaren e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Zv. Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit), të cilës iu kërkuar që të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me objektin e çështjes së kontestuar dhe që një kopje të kërkesës t'ua dorëzojë të gjithë deputetëve të zgjedhur të Kuvendit. Afati për dorëzimin e komenteve dhe dokumenteve relevante të Kuvendit, u caktua më së largu deri më 18 shtator 2026.
14. Më 15 shtator 2026, gjyqtari Radomir Laban kërkoi përjashtimin e tij nga vendimmarrja lidhur me kërkesat KO256/26 dhe KO258/26.
15. Më 17 shtator 2026, Gjykata refuzoi kërkesën për përjashtim të gjyqtarit Radomir Laban.
16. Më 17 shtator 2026, Zv. Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin në vijim:
- (i) Vendimin e Ushtrueses së Detyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës për thirrjen e Seancës Konstituive të Legjislaturës së XI, të 24 korrikut 2026;
 - (ii) Ftesën dhe rendin e ditës për mbajtjen e Seancës Konstituive të Legjislaturës së XI, të 6 gushtit 2026;
 - (iii) Ftesën dhe rendin e ditës për vazhdimin e Seancës Konstituive të Legjislaturës së XI, të 8 gushtit 2026;
 - (iv) Ftesën dhe rendin e ditës për vazhdimin e Seancës Konstituive të Legjislaturës së XI, të 9 shtatorit 2026;
 - (v) Njoftimin për vazhdimin e Seancës Konstituive të Legjislaturës së XI, më 11 shtator 2026, në ora 11:00;
 - (vi) Ftesën dhe rendin e ditës për vazhdimin e Seancës Konstituive të Legjislaturës së XI, të 11 shtatorit 2026, në ora 14:00;
 - (vii) Njoftimin për vazhdimin e Seancës Konstituive të Legjislaturës së XI, më 13 shtator 2026, në ora 10:00;
 - (viii) Vendimin [nr. 11-V-002], e 9 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës;
 - (ix) Vendimin [nr. II-V-003], e 11 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Kuvendit, Ardian Gola;
 - (x) Vendimin [nr. 11-V -016], e 11 shtatorit 2026, për moszgjedhjen e Nënkrjetares së Kuvendit, Vlora Çitaku;
 - (xi) Vendimin [nr. II-V-004], e 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Nënkrjetarit të Kuvendit, Kujtim Shala;
 - (xii) Vendimin [nr. II-V-005], e 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Nënkrjetares së Kuvendit, Tanja Vujović;
 - (xiii) Vendimin [nr. II-V-006], e 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Nënkrjetares së Kuvendit, Emilija Redžepi;
 - (xiv) Transkriptet e Seancës Konstituive të Legjislaturës së XI, të mbajtura më 6 dhe 8 gusht, si dhe më 9, 11 dhe 13 shtator 2026;
 - (xv) Ftesën dhe rendin e ditës për mbajtjen e Seancës së jashtëzakonshme plenare, më 13 shtator 2026, në ora 14:00;
 - (xvi) Vendimin [nr. II-V-007], e 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës;

- (xvii) Transkriptin e Seancës së jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 13 shtator 2026, lidhur me zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
17. Më 18 shtator 2026, Kryetarja e Kuvendit znj. Albulena Haxhiu, deputetja Arbërie Nagavci, nga Lëvizja Vetëvendosje!, deputeti z. Burim Ramadani nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (në tekstin e mëtejme: AAK), Artan Asllani nga Grupi Parlamentar Multietnik dhe deputetja Jehona Lushaku-Sadriu, nga Lidhja Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: LDK), dorëzuan komente lidhur me kërkesat.
18. Më 21 shtator 2026, Gjykata, përkitazi me komentet e pranuar, njoftoi: (i) parashtruesit e kërkesave; (ii) U.d. Presidenten; (iii) Kryeministrin; (iv) Zv. Sekretaren e Përgjithshme të Kuvendit.
19. Më 23 shtator 2026, Gjykata shqyrtoi propozimin e Gjyqtare raportuese dhe njëzëri vendosi (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë që Kuvendi i Republikës së Kosovës është konstituuar pas kalimit të afatit tridhjetë (30) ditor, të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (iii) të konstatojë që kalimi i afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka për pasojë fillimin e rrjedhjes së afateve kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, kur posti i Presidentit është vakant dhe për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas neneve 86 [Zgjedhja e Presidentit], 95 [Zgjedhja e Qeverisë] dhe nënparagrafëve 1 dhe 3, paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (iv) të konstatojë që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet që sa më parë të zgjedhin Nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e grupit të dytë më të madh parlamentar, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (v) të konstatojë që Vendimi [Nr. 11-V-007] i 13 shtatorit 2026 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk është në kundërshtim me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (vi) të konstatojë që afati gjashtëdhjetë (60) ditor për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, sipas nënparagrafit 3, paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka filluar më 8 gusht 2026 dhe përfundon më 6 tetor 2026; (vii) të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme; (viii) t'ua kumtojë këtë Aktgjykim palëve; (ix) të publikojë këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe (x) të konstatojë që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 7 qershor 2026, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
21. Më 27 qershor 2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të mbajtura më 7 qershor 2026.
22. Më 8 korrik 2026, KQZ përmes Vendimit [nr. 011433-2026] certifikoi rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend të mbajtura më 7 qershor 2026.

23. Më 24 korrik 2026, U.d. Presidentja, përmes Vendimit [nr. 30/2026] thirri Seancën Konstituive të Legjislaturës XI të Kuvendit, e cila u caktua të mbahet më 6 gusht 2026, në ora 10:00.
24. Më 6 gusht 2026, filloi Seanca Konstituive, e kryesuar nga deputeti më i vjetër i Kuvendit, z. Avni Dehari (në tekstin e mëtejshëm: Kryesuesi), sipas rendit të ditës si në vijim: (i) Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve; (ii) Betimi i deputetëve; (iii) Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit dhe (iv) Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit.
25. Në të njëjtën ditë, Kuvendi, në Seancën Konstituive të Legjislaturës XI të Kuvendit, zgjodhi Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni i Përkohshëm). Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioni i Përkohshëm konstatoi vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit, sipas Vendimit të KQZ-së për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin dhe rekomandoi vazhdimin e Seancës Konstituive. Gjithashtu, në kuadër të kësaj seance, të gjithë deputetët dhanë betimin e tyre.
26. Po të njëjtën ditë, Kryesuesi, vazhdoi me rendin e ditës dhe kërkoi nga Lëvizja Vetëvendosje! ta propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit, ku kjo e fundit kërkoi kohë shtesë, në mënyrë që t'iu jepet mundësia për bisedime politike dhe për arritjen e një marrëveshjeje për President.
27. Më 8 gusht 2026, vazhdoi Seanca Konstituive e Kuvendit gjatë së cilës Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje! kërkoi kohë shtesë për të propozuar kandidatin për Kryetar të Kuvendit, duke theksuar *“Marrëveshje politike nuk kemi ende. Prandaj, që t'i evitojmë zgjedhjet e reja, ju lus për kohë shtesë”*.
28. Më 4 shtator 2026, Kryesuesi, përmes ftesës [L-XI SK-001/2], caktoi vazhdimin e Seancës Konstituive për zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit për datën 9 shtator 2026.
29. Më 9 shtator 2026, pas kërkesës së Kryesuesit, përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje! propozoi znj. Albulena Haxhiu për Kryetare të Kuvendit. Propozimi i Lëvizjes Vetëvendosje! i mori gjashtëdhjetë e dy (62) vota për, gjashtëmbëdhjetë (16) kundër dhe trembëdhjetë (13) abstenime.
30. Në të njëjtën ditë, përmes Vendimit [nr. 11-V-002], znj. Albulena Haxhiu u zgjodh Kryetare e Kuvendit.
31. Nga shkresat e lëndës rezultoi se, më 11 shtator 2026, me shtatëdhjetë e një (71) vota për, dhjetë (10) kundër dhe një (1) abstenim u miratua propozimi i Kryetares së Kuvendit që votimi i nënkryetarëve të bëhej veç e veç dhe jo në pako.
32. Në të njëjtën ditë, përfaqësuesja e Lëvizjes Vetëvendosje! propozoi deputetin z. Ardian Gola nga Lëvizja Vetëvendosje! për nënkryetar të Kuvendit, propozim i cili kaloi me njëqind e një (101) vota për, asnjë kundër dhe një (1) abstenim. Përmes Vendimit [nr. 11-V-003] z. Ardian Gola u zgjodh nënkryetar i Kuvendit.

33. Gjatë të njëjtës seancë, përfaqësuesi i PDK-së propozoi deputeten znj. Vlora Çitaku për nënkryetare të Kuvendit, propozim i cili nuk kaloi pasi mori dyzet e katër (44) vota për, një (1) kundër dhe pesëdhjetë e gjashtë (56) abstenime.
34. Më 13 shtator 2026, përfaqësuesi i PDK-së iu drejtua Kryetares së zgjedhur të Kuvendit me njoftim për *“tërheqjen e përkohshme të kandidaturës së znj. Vlora Çitaku”* për pozitën e nënkryetares së Kuvendit, me arsyetimin se: *“[...] Partia Demokratike e Kosovës do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar vlerësimin dhe sqarimin kushtetues të situatës së krijuar. Deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ne tërheqim (pezullojm) kandidaturën tonë për nënkryetare të Kuvendit dhe nuk do të marrim pjesë në vazhdimin e një procesi, i cili, në vend që të prodhojë konstituimin e Kuvendit, është shndërruar në një seri seancash pa rezultat institucional.”*
35. Më 13 shtator 2026, Kryetarja e Kuvendit, në vazhdimin e Seancës Konstituive deklaroi: *“Vazhdojmë, pra me seancën konstituive. Në seancën e së premtes kam bërë thirrje disa herë që PDK-ja të marrë pjesë në vazhdimin e seancës konstituive dhe të bëjë propozimin për nënkryetare të Kuvendit, sot është hera e tretë që PDK-ja nuk merr pjesë në seancën konstituive për të bërë propozimin sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pra, përkundër faktit që PDK ka qenë e njoftuar me vazhdimin e seancës konstitutive, nuk është e pranishme, rrjedhimisht edhe nuk po e ushtron të drejtën kushtetuese. Bazuar edhe në qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi nuk mund të mbetet peng i askujt, i asnjë subjekti politik, prandaj edhe vazhdojmë me propozimin nga Lidhja Demokratike e Kosovës, [...]”*
36. Në të njëjtën ditë, përmes vendimeve [nr. 11-V-004; nr. 11-V-005; dhe nr. 11-V-006] (i) deputeti z. Kujtim Shala nga LDK, me shtatëdhjetë e pesë (75) vota për, një (1) kundër dhe katër (4); (ii) deputetja znj. Tanja Vujović, nga Lista Serbe, me gjashtëdhjetë e dy (62) vota për, gjashtë (6) kundër dhe tre (3) abstenime; si dhe (iii) znj. Emilija Redžepi, nga komunitetet tjera joshumicë, me shtatëdhjetë (70) vota për, asnjë kundër dhe shtatë (7) abstenime u zgjodhën nënkryetarë të Kuvendit.
37. Sipas Transkriptit të Seancës së Kuvendit të 13 shtatorit 2026, Kryetarja e zgjedhur e Kuvendit konstatoi që *“Kuvendi i Republikës së Kosovës konsiderohet i konstituuar”*.
38. Më 13 shtator 2026, U.d. Presidentja, përmes Dekretit [nr. 169/2026] për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria), e propozoi z. Albin Kurti kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë.
39. Në të njëjtën ditë, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! iu drejtuan Kryetares së zgjedhur të Kuvendit me kërkesë për thirrjen e Seancës së Jashtëzakonshme të Kuvendit për 13 shtator 2026 në orën 14:00 për zgjedhjen e Qeverisë.
40. Më 13 shtator 2026, Kuvendi, përmes Vendimit [Nr. 11-V-007], zgjodhi Qeverinë.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesave

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO256/26

41. Parashtruesit e kërkesës KO256/26 kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së *“Vendimit nr.11-V-002, të 9 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit; Vendimit procedural të 11 shtatorit 2026 për mënyrën e votimit të nënkryetarëve; dhe konstatimit*

të 13 shtatorit 2026 për konstituimin e legjislaturës XI të Kuvendit”, në raport me nenin 4 [Forma e Qeverisjes], nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati], paragrafët 1 dhe 2 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit], nenin 76 [Rregullorja e Punës], nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] si dhe nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës në ndërlidhje me “Kreun IV të Rregullores së Kuvendit dhe jurisprudencën e Gjykatës në rastet KO124/25, KO193/25 dhe KO196/25, KO265/25, KO325/25, si dhe, për qëllime të masës së përkohshme, KO72/26 dhe KO74/26”.

42. Përkitazi me Vendimin [nr.11-V-002] e 9 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit, parashtruesit e kërkesës KO256/26 pretendojnë se *“afati tridhjetëditor i nenit 66.1 ka përfunduar më 7 gusht 2026”, marrë parasysh se certifikimi i rezultateve për zgjedhjet e parakohshme ishte bërë më 8 korrik 2026. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “pikënisja e kontrollit kushtetues është vetë paragrafi 1 i nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës, i cili përcakton: “Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.” Afati tridhjetëditor, pra, nuk është krijuar nga jurisprudenca. Ai është norme e drejtpërdrejtë kushtetuese, ndërkaq jurisprudenca e Gjykatës i ka përcaktuar kuptimin, përmbajtjen dhe efektin praktik”.*
43. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar Aktgjyqimit të Gjykatës në rastin KO124/25, theksojnë se *“Në KO124/25, paragrafi 131, Gjykata ka konstatuar se “mbajtja e seancës konstituive brenda afatit tridhjetë (30) ditor, nuk është mundësi formale apo orientuese, por detyrim kushtetues”. Në paragrafin 132, ajo ka sqaruar se kjo kërkesë “nuk do të thotë vetëm që deputetët e zgjedhur duhet të mbledhen fizikisht në sallë”, por që brenda afatit duhet të realizohen të gjitha veprimet kushtetuese që rezultojnë në konstituimin e Kuvendit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve; pa përfundimin me sukses të tyre, “Kuvendi nuk mund të konsiderohet juridikisht i konstituuar”. Ky standard e përjashton interpretimin sipas të cilit fillimi formal i Seancës më 6 gusht do të mjaftonte për përmbushjen e nenit 66.1. Në paragrafin 140 të KO124/25, Gjykata e ka bërë standardin edhe më të qartë: afati tridhjetëditor “nuk mund të trajtohet si afat brenda të cilit vetëm duhet provuar konstituimi i Kuvendit”, por është afat “brenda të cilit duhet të konstituohet Kuvendi”. Në paragrafin 145, Gjykata ka konstatuar se Seanca Konstituive “duhet të përmbushet me sukses brenda 30 (tridhjetë) ditëve” përmes të gjitha elementeve thelbësore dhe se “çdo interpretim ndryshe do të relativizonte rendin kushtetues...dhe do të nënkuptonte tolerim të bllokimit institucional”. Në paragrafin 186, Gjykata ka përsëritur se pas betimit të deputetëve Seanca duhet të finalizohet me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve.”. Më tej, parashtruesit e kërkesës shtojnë se i njëjti standard është ritheksuar në Aktgjyqimet e Gjykatës KO193/25 dhe KO196/25, KO265/25, si dhe KO325/25, ku është konstatuar se konstituimi i Kuvendit përfundon vetëm pasi të përfundojë zgjedhja e të gjithë anëtarëve të Kryesisë, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor, të përcaktuar me Kushtetutë.*
44. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës para Gjykatës pretendojnë se Vendimi për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit është miratuar më 9 shtator 2026, më shumë se një muaj pas përfundimit të afatit për konstituimin e Kuvendit. Sipas parashtruesve të kërkesës *“[...] skadimi i afatit nuk e shuan detyrimin material për konstituimin e Kuvendit dhe se ky detyrim vazhdon sepse shteti duhet të ketë organ legjislativ funksional. Megjithatë, vazhdimi i detyrimit nuk mund të barazohet me mungesën e pasojës juridike të skadimit. Pas 7 gushtit, shkelja e afatit ishte konsumuar dhe konstituimi i mëvonshëm nuk mund ta*

transformojë retroaktivisht një konstituim jashtë afatit në konstituim brenda afatit. [...]". Në lidhje me çështjen e trajtimit të afatit nga ana e Gjykatës, parashtruesit e kërkesës mbështeten te rastet e Gjykatës KO72/26 dhe KO74/26, për të cilat argumentojnë se, edhe pse kishin objekt tjetër, parimi interpretues është relevant pasi që "afati i shkruar në Kushtetutë nuk mund të reduktohet në orientim pa pasoja, sepse një interpretim i tillë do ta zbraste normën nga përmbajtja dhe qëllimi i saj".

45. Tutje, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është cenuar detyrimi procedural i përcaktuar përmes paragrafit 5 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit ku parashihet se ndërprerjet gjatë Seancës Konstituive nuk mund të jenë më të gjata se dyzet e tetë (48) orë. Parashtruesit e kërkesës shtojnë se, pas 8 gushtit 2026, Seanca Konstituive nuk është thirrur brenda 48 (dyzet e tetë) orëve, duke kaluar javë pa vazhdim të saj, pavarësisht shkresave të PDK-së, të 12, 14, 16, 18, 20, 22, 24, 26, 28 dhe 30 gushtit, si dhe të 1, 3 dhe 5 shtatorit 2026, drejtuar Kryesuesit për vazhdimin e Seancës Konstituive, përmes të cilave sipas parashtruesve të kërkesës "është theksuar shprehimisht se tejkalimi i afatit kushtetues nuk e shuan detyrimin për ta konstituuar Kuvendin dhe se mosrespektimi i afateve të Rregullores e thellon gjendjen e shkëljes kushtetuese.". Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se "Mbi të gjitha, vetë Gjykata e ka inkorporuar afatin 48-orësh në standardin kushtetues të konstituimit. Në rastet KO193/25 dhe KO196/25, paragrafi 157, Gjykata ka theksuar se Kryesuesi duhet ta realizojë thirrjen dhe mbajtjen e Seancës në pajtim me Kushtetutën, Kreun IV të Rregullores dhe aktgjykimin e saj dhe ka rikujtuar shprehimisht rëndësinë e paragrafit 5 të nenit 12, i cili përcakton se "Ndërprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë." Rrjedhimisht, mosftesa e Seancës për javë të tëra pas 8 gushtit ishte jo vetëm shmangie nga Rregullorja, por shmangie nga standardi që Gjykata e kishte lidhur drejtpërdrejt me përmbushjen e detyrimit kushtetues për konstituim.".
46. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se dështimi për të zgjedhur Kryetarin brenda afatit nuk mund t'u atribuohet deputetëve në përgjithësi, pasi më 6 dhe 8 gusht 2026 nuk ishte propozuar asnjë kandidat për t'u votuar. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se paragrafi 2 i nenit 67 të Kushtetutës rezervon propozimin për grupin më të madh parlamentar, mirëpo në rastin konkret, bartësi ekskluziv i të drejtës së propozimit nuk paraqiti kandidat për votim dhe, rrjedhimisht, deputetët e tjerë nuk kishin objekt votimi dhe nuk mund të ushtronin detyrimin e tyre kushtetues. Sipas parashtruesve të kërkesës, "Vlerësimi i tërësisë se kronologjisë se procesit po ashtu është relevant për identifikimin e shkaktit objektiv të moskonstituimit të Kuvendit brenda afatit kushtetues. Seanca Konstituive është thirrur me 6 gusht 2026, vetëm një ditë para përfundimit të afatit tridhjetëditor sipas pikënisjes më favorizuese për Kuvendin; në atë seancë grupi më i madh parlamentar nuk ka paraqitur kandidat për Kryetar; më 8 gusht, tashmë pas skadimit të afatit, kandidatura përsëri nuk është paraqitur dhe është kërkuar "kohë shtesë"; ndërsa më pas Seanca nuk është vazhduar për javë të tëra, pavarësisht kufirit 48-orësh dhe kërkesave të përsëritura të PDK-së për vazhdimin e saj. Kandidatura për Kryetare është paraqitur vetëm më 9 shtator. Kjo sekuencë duhet të vlerësohet përballë standardit të Gjykatës sipas të cilit konstituimi duhet të përfundojë "sa më shpejtë dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë". Në këtë kuptim, faktet nuk mbështesin një narrativë sipas së cilës pengesa për konstituimin ka buruar nga PDK-ja; përkundrazi, provat materiale dëshmojnë se PDK ka kërkuar vazhdimisht thirrjen e Seancës, ndërsa pamundësia e deputetëve për të votuar Kryetarin brenda afatit ka ardhur fillimisht nga mosparaqitja e kandidaturës nga bartësi ekskluziv i së drejtës së propozimit dhe më pas nga mosvazhdimi i Seancës brenda afateve procedurale. Këto rrethana nuk kërkojnë që

Gjykata të përcaktojë motivet politike të subjekteve parlamentare; ato mjaftojnë për të përcaktuar shkakun objektiv të vonës dhe përgjegjësitë kushtetuese që lidhen me të”.

47. *Rrjedhimisht, parashtuesit e kërkesës KO256/26 argumentojnë se “Vendimi i kontestuar I është jokushtetues për sa i përket procedurës së ndjekur në miratimin e tij: ai është akt konstituiv i nxjerrë pasi afati kushtetues ishte konsumuar, pas një ndërprerjeje që kishte tejkaluar haptazi kufirin 48-orësh dhe pas një periudhe në të cilën grupi me të drejtën ekskluzive të propozimit nuk e kishte ushtruar atë brenda afatit. Gjykata duhet të përcaktojë efektin juridik të kësaj gjendjeje dhe jo ta trajtojë vendimin sikur ai të ishte miratuar brenda procedurës së rregullt kushtetuese.”*
48. *Përkitazi me Vendimin procedural të 11 shtatorit 2026 për votimin veç e veç të nënkryetarëve nga tri grupet më të mëdha parlamentare, parashtuesit e kërkesës KO256/26, ndër të tjera, pretendojnë që “mënyra se si Kuvendi e përcaktoi dhe e aplikoi ndryshimin procedural më 11 shtator duhet të vlerësohet në dritën e tërësisë së standardeve të Gjykatës, praktikës parlamentare dhe qëllimit kushtetues për përfundimin e suksesshëm të Seancës. Vetë KO265/25, në fund të paragrafit 121, ka kushtëzuar fleksibilitetin e procedurës me rezultatin kushtetues, duke theksuar se procedura e votimit mbetet në vullnetin e deputetëve dhe grupeve parlamentare “me kushtin që të realizohet zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit”. Në paragrafin 122, Gjykata ka evidentuar se në praktikën konkrete të asaj legjislature, nënkryetarët nga tri grupet më të mëdha parlamentare u votuan në pako mbi bazën e konsensusit. Kjo nuk krijon normë absolute për votimin në pako, si formë e votimit, por konfirmon se konsensusi dhe funksionalizimi janë elemente qendrore të zgjedhjes së mënyrës së votimit.”.*
49. *Më tej, parashtuesit e kërkesës pretendojnë se Kryetarja e Kuvendit, më 9 shtator 2026, kishte konstatuar se “forma e votimit nuk ishte përcaktuar në takimin përgatitor dhe se nuk kishte pajtim mes grupeve”, ndërkaq që, më 11 shtator 2026, sipas parashtuesve të kërkesës “ajo ka deklaruar se, pikërisht për shkak të mungesës së dakordimit për votimin në pako (të të gjithë nënkryetarëve përnjëherësh), “forma e vetme” ishte votimi veç e veç”. Pas kundërshtimeve, metoda e votimit është vënë vetë në votim dhe është miratuar me 71 vota për, 10 kundër dhe 1 abstenim. Ky hap e ka zëvendësuar konsensusin ndërmjet bartësve të të drejtave kushtetuese me vendimin e shumicës për vetë procedurën që do të rregullonte ushtrimin e këtyre të drejtave.”.*
50. *Në këtë drejtim, parashtuesit e kërkesës pretendojnë se pasojat e votimit në mënyrën e lartcekur janë konkrete pasi përderisa kandidati i grupit më të madh u zgjodh me njëqind e një (101) vota, kandidatja e PDK-së mori dyzet e katër (44) vota për, një (1) kundër dhe pesëdhjetë e gjashtë (56) abstenime. Sipas parashtuesve të kërkesës, “PDK e kishte ushtruar të drejtën e propozimit; dështimi erdhi në fazën e votimit nga i gjithë Kuvendi. Më pas, pikërisht ky rezultat u përdor për të krijuar premisën e një “bllokimi” që, në fund, u atribuua PDK-së.”. Në këtë aspekt, parashtuesit e kërkesës argumentojnë se “shumica nuk mund të krijojë përmes mënyrës së votimit dhe mosmbështetjes së kandidatit të propozuar një situatë të papërfunduar dhe pastaj ta përdorë atë situatë për të anashkaluar bartësin e së drejtës së propozimit.” Sipas parashtuesve të kërkesës, kjo nuk do të thotë se kandidati i propozuar nga një grup parlamentar zgjedhet automatikisht pasi paragrafi 3 i nenit 67 të Kushtetutës kërkon shumicën e votave të të gjithë deputetëve, por theksojnë që “diskrecioni i deputetëve për të votuar për, kundër ose abstenuar duhet të lexohet së bashku me nenin 74 dhe me detyrimin e mirëbesimit”.*

51. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që: *“Gjykata duhet të vlerësojë nëse, në mungesë të konsensusit për ndryshimin e praktikës dhe në kushtet kur metoda e zgjedhur prodhoi moszgjedhjen vetëm të kandidatit të njërit prej tri grupeve më të mëdha, vendimi procedural i 11 shtatorit dhe mënyra e zbatimit të tij kanë respektuar nenet 66, 67, 74 dhe 76 të Kushtetutës, Kreun IV të Rregullores dhe standardin e mirëbesimit të përcaktuar nga jurisprudenca. Ky vlerësim është veçanërisht i domosdoshëm për shkak se rezultati i kësaj procedure u përdor më pas si premisë për aktivizimin e një mekanizmi përjashtimor deblokues, i cili si i tillë është në kundërshtim me praktikën e deritanishme parlamentare.”*
52. Tutje, parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar paragrafëve 147-148 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO265/25, theksojnë se Seanca Konstituive përfundon me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve dhe se *“Në paragrafin 148 të KO265/25, Gjykata ka sqaruar se, kur e drejta e propozimit “nuk ushtrohet nga deputetët apo grupet parlamentare, që kanë të drejtë të propozojnë” dhe kjo mund të manifestohet në pengimin e procesit, ose kur, “përkundër vullnetit të shumicës së deputetëve”, Kuvendi i pamundësohet zgjedhja e një anëtari të Kryesisë, Kuvendi “përjashtimisht, do të mund të vazhdojë funksionimin pa ndonjë nga anëtarët e Kryesisë”, me kushtin e kuorumit të Kryesisë. Por po në të njëjtin paragraf, Gjykata ka bërë të qartë kufirin e këtij përjashtimi, duke konstatuar se ai nuk zbatohet kur dështimi për zgjedhje i atribuohet “mosvotimit të shumicës së deputetëve për kandidatët e propozuar”.*
53. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se grupi parlamentar i PDK-së nuk ka refuzuar ta ushtrojë të drejtën e propozimit, pasi më 9 shtator 2026 kishin propozuar znj. Vlora Çitaku për nënkryetare, propozim i cili ishte vendosur në votim në Kuvend më 11 shtator 2026. Prandaj, sipas parashtruesve të kërkesës *“fakti juridik që aktivizon pjesën e parë të paragrafit 148 - mosushtimi i së drejtës së propozimit - nuk ekziston. Një e drejtë kushtetuese e ushtruar konkretisht nuk mund të rikarakterizohet retroaktivisht si e parrealizuar vetëm pse kandidati nuk mori shumicën e nevojshme. Rezultati 44 vota për, 1 kundër dhe 56 abstenime dëshmon se kandidatja e propozuar nga PDK nuk dështoi për shkak të mungesës së propozimit, por për shkak të mosmarrjes së votave të nevojshme nga Kuvendi.”*
54. Parashtruesit e kërkesës argumentojnë se mospjesëmarrja në këto rrethana është mënyrë e shprehjes së kundërshtimit ndaj kushtetutshmërisë së procedurës, por jo akt juridik i heqjes dorë nga e drejta që paragrafi 3 i nenit 67 të Kushtetutës ia rezervon grupit parlamentar, aq më pak kur, sipas tyre, PDK e ka ushtruar të drejtën e propozimit të nënkryetarit paraprakisht, duke propozuar kandidaten e saj; ka marrë pjesë në votimin e saj; ka kërkuar në mënyrë aktive përfundimin e Seancës Konstituive; dhe para konstatimit të 13 shtatorit 2026, për konstituimin e Kuvendit, ka dorëzuar njoftim të shkruar me të cilin ka informuar Kryetaren e Kuvendit se mosparaqitja e kandidaturës është e përkohshme dhe nuk përbën heqje dore apo refuzim të së drejtës së propozimit. Tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se fakti që Kryesia ka kuorum me pesë anëtarë nuk është kusht i mjaftueshëm për të kapërcyer rregullin e nenit 67 të Kushtetutës pasi kuorumi bëhet relevant vetëm pasi është aktivizuar në mënyrë të ligjshme përjashtimi i paragrafit 148 në Aktgjykimin e Gjykatës KO265/25.
55. Rrjedhimisht, përkritazi me *“konstatimi[n] [e] 13 shtatorit 2026 se PDK “Nuk po e ushtron” të drejtën e propozimit dhe se Kuvendi konsiderohet i konstituuar pa nënkryetarin e grupit të dytë më të madh”*, parashtruesit e kërkesës shtojnë se *“konstatimi i Kryetares më 13 shtator se Kuvendi “konsiderohet i konstituuar” është jokushtetuese në dy aspekte të*

veçanta: së pari, sepse vetë konstituimi është deklaruar shumë kohë pas afatit detyrues të nenit 66.1; dhe, së dyti, sepse në atë moment nuk ishte zgjedhur njëri nga nënkryetarët e nenit 67.3, ndërsa kushtet e ngushta të përjashtimit të paragrafit 148 nuk ishin plotësuar. Kjo e bën kontrollin e Gjykatës të domosdoshëm për statusin kushtetues të Legjislaturës XI dhe për vlefshmërinë e akteve që burojnë nga ky status.”

56. Tutje, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se, përveç që duhet të japë përgjigje përfundimtare nëse ka pasur shkelje të afatit, Gjykata duhet të japë përgjigje lidhur me pasojën juridiko-kushtetuese të një situatë ku Kuvendi, pavarësisht standardit të përcaktuar në jurisprudencën e Gjykatës, deklarohet i konstituuar pas afatit. Sipas parashtruesve të kërkesës, *“Pa përgjigje mbi pasojën, norma e nenit 66.1 rrezikon të humbasë efektin praktik dhe qëllimin normativ dhe kushtetues.”*
57. Në fund të kërkesës KO256/26, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se Vendimi [nr. 11-V-002] i Kuvendit i 9 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit, për sa i përket procedurës së ndjekur në miratimin e tij pas përfundimit të afatit kushtetues për konstituim, nuk është në përputhje me paragrafin 1 të nenit 66, paragrafët 1 dhe 2 të nenit 67, nenin 74, dhe nenin 76 të Kushtetutës; (iii) të konstatojë se vendimi procedural i Kuvendit, i materializuar në Transkriptin e 11 shtatorit 2026, për votimin veç e veç të kandidatëve për nënkryetarë nga tri grupet më të mëdha parlamentare, është nxjerrë në kundërshtim me nenet 66, 67, 74 dhe 76 të Kushtetutës, në ndërlidhje me standardet e jurisprudencës së Gjykatës mbi mirëbesimin, konsensusin, praktikën parlamentare dhe përfundimin me sukses të Seancës Konstituive; (iv) të konstatojë se konstatimi i Kryetares së Kuvendit, i materializuar në Transkriptin e Seancës Konstituive të 13 shtatorit 2026, sipas të cilit Kuvendi konsiderohej i konstituuar, nuk i plotëson kushtet e mekanizmit përjashtimor të përcaktuar në paragrafin 148 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO265/25 dhe nuk është në përputhje me nenet 66 dhe 67 të Kushtetutës; (v) të përcaktojë pasojat juridiko-kushtetuese të tejkalimit të afatit tridhjetëditor të nenit 66 të Kushtetutës dhe efektin juridik të vendimeve dhe veprimeve të ndërmarra pas skadimit të këtij afati, në mënyrë që afati kushtetues të ruajë karakterin e tij detyrues dhe efektin praktik; (vi) të përcaktojë statusin kushtetues të Legjislaturës XI të Kuvendit dhe të veprimeve institucionale të ndërmarra mbi bazën e konstatimit të 13 shtatorit 2026 se Kuvendi është konstituuar; dhe (vii) të caktojë masën e përkohshme, duke pezulluar efektet juridike që varen nga konstatimi i kontestuar i konstituimit të Kuvendit, përfshirë rrjedhën dhe zhvillimin e procedurës kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO258/26

58. Parashtruesit e kërkesës KO258/26 kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së *“Vendimit Nr. 11-V-007, të 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës”*, për të cilin pretendojnë në raport me nenet 4 [Forma e Qeverisjes], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 66 [Zgjedhja dhe Mandati], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], 74 [Ushtrimi i Funksionit], 92 [Parimet e Përgjithshme], 93 [Kompetencat e Qeverisë], 95 [Zgjedhja e Qeverisë], 112 [Parimet e Përgjithshme] dhe 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës.
59. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“Pretendimi për kundërkushtetutshmëri kufizohet vetëm në faktin se kompetenca e nenit 95 për të zgjedhur Qeverinë mund të ushtrohet vetëm nga një Kuvend që është konstituuar në pajtim me nenet 66 dhe 67 të Kushtetutës.*

Në vlerësimin e parashtruesve, më 13 shtator 2026 ky parakusht kushtetues nuk ekzistonte”.

60. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar praktikës së Gjykatës, konkretisht rastit KO124/25, paragrafi 132, pretendojnë se: *“[...] një organ që nuk mund të konsiderohet juridikisht i konstituuar nuk mund të trajtohet, vetëm disa orë më vonë, sikur e ka fituar plotësisht kompetencën kushtetuese për zgjedhjen e ekzekutivit”.* Po ashtu, parashtruesit e kërkesës u referohen rasteve të Gjykatës KO265/25 dhe KO325/25 duke theksuar se: *“[...] Gjykata ka përsëritur se konstituimi përfundon vetëm pas përmbushjes së të gjitha elementeve thelbësore, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve”.* Parashtruesit e kërkesës shtojnë se: *“[...] statusi i Kuvendit si organ i konstituuar është parakusht logjik dhe juridik për kalimin nga faza e vetëkonstituimit në ushtrimin e kompetencave të rregullta kushtetuese, përfshirë nenin 95”.*
61. Tutje, përkitazi me pretendimin e mospërfundimit të konstituimit të Kuvendit brenda afatit kushtetues, parashtruesit e kërkesës shtojnë se: *“Në rastin konkret edhe duke përdorur datën më të vonshme të certifikimit, 8 korrikun 2026, afati ka përfunduar më 7 gusht. Kryetarja e Kuvendit është zgjedhur vetëm më 9 shtator, ndërsa konstatimi se Kuvendi konsiderohej i konstituuar është bërë më 13 shtator. Konstituimi i mëvonshëm nuk mund ta transformojë retroaktivisht një proces të zhvilluar jashtë afatit në proces të përfunduar brenda afatit”.*
62. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është zbatuar paragrafi 5 i nenit 12 të Rregullores dhe është tejkaluar kufiri procedural prej dyzet e tetë (48) orësh për ndërprerjet gjatë Seancës Konstitutive.
63. Tutje, përkitazi me moszgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit brenda afatit kushtetues, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk mund t’u atribuohet deputetëve në përgjithësi, për shkak se më 6 dhe 8 gusht 2026 nuk kishte pasur kandidat për të votuar dhe se e drejta për propozim i takonte grupit më të madh parlamentar.
64. Parashtruesit e kërkesës shtojnë se përbërja e Kryesisë nuk ishte në përputhje me Kushtetutën duke iu referuar rastit të Gjykatës KO265/25, me arsyetimin se mundësia e funksionimit pa një anëtar të Kryesisë, është vetëm në ato rrethana ku e drejta e propozimit nuk ushtrohet ose zgjedhja pamundësohet përkundër vullnetit të shumicës.
65. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“PDK e kishte ushtruar të drejtën e saj duke propozuar znj. Vlora Çitaku dhe kandidatura kishte dështuar për shkak të mosmarrjes së shumicës së nevojshme në Kuvend. [...] As mospjesëmarrja e PDK-së në vazhdimin e 13 shtatorit nuk mund të prodhojë, vetvetiu, efektin e shuarjes së një të drejte kushtetuese. Grupi e kishte ushtruar më parë të drejtën, kishte kërkuar vazhdimisht konstituimin e Kuvendit dhe, para konstatimit të Kryetares, kishte dorëzuar njoftim të shkruar se pezullimi ishte i përkohshëm dhe nuk nënkuptonte refuzim”.*
66. Në vijim, parashtruesit e kërkesës i referohen rastit KO95/20 duke theksuar se: *“[...] Gjykata [...] pasi kishte konstatuar se mandati i njërit deputet ishte i pavlefshëm para votimit, ajo vlerësoi se pa atë votë vendimi kishte vetëm 60 vota të vlefshme. Në paragrafin 281, për këtë arsye, Gjykata konstatoi se Vendimi për zgjedhjen e Qeverisë “nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën” sepse nuk kishte marrë “61 vota të vlefshme” sipas nenit 95.3”. Në këtë rrjedhë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se analogjia në këto dy raste qëndron “[...] në parimin juridik që del prej këtij Aktgjykimi:*

përmbushja formale e procedurës dhe regjistrimi i një rezultati votimi nuk e përligjin gjendjen kundërkushtetuese që ekziston në momentin e vendimmarrjes. [...] Në rastin e tanishëm, çështja është: a e kishte vetë organi që votoi Qeverinë statusin kushtetues të një Kuvendi të konstituuar dhe kompetencën për të kaluar në ushtrimin e nenit 95”.

67. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se kërkesat KO256/26 dhe KO258/26 “[...] kanë një çështje paraprake të përbashkët: statusin kushtetues të Kuvendit në momentin kur është ushtruar kompetenca për zgjedhjen e Qeverisë”. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksuan se: “[...] objekti i tanishëm është juridikisht i veçantë. Vendimi nr. 11-V-007 është akt i ri i Kuvendit, i miratuar më 13 shtator, i cili prodhon pasoja të pavarura për organizimin e pushtetit ekzekutiv dhe të cilit rrjedh afati i vet tetëditor sipas nenit 113.5”.
68. Në fund të kërkesës KO258/26, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: “(i) të deklarojë të pranueshme këtë kërkesë; (ii) të konstatojë se Vendimi nr. 11-V-007 i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i datës 13 shtator 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nuk është në përputhje me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 4, 16, 66, 67, 74 dhe 92 të Kushtetutës, sepse është miratuar nga një Legjislaturë e cila nuk kishte përfunduar konstituimin në pajtim me kërkesat kushtetuese; (iii) të konstatojë se kompetenca e Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë sipas nenit 95 mund të ushtrohet vetëm pas konstituimit të Kuvendit në pajtim me nenet 66 dhe 67 të Kushtetutës dhe se plotësimi i pragut numerik të votave nuk e shënon mungesën e këtij parakushti kushtetues”.

Kërkesa për masë të përkohshme

69. Parashtruesit e kërkesës KO256/26 po ashtu kërkojnë nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme me arsyetimin se “*duke qenë se kërkesa e tanishme përfshin jo vetëm vendime konkrete, por edhe një vendim procedural të materializuar në transkript dhe një konstatim me pasoja për statusin e tërë Kuvendit, parashtruesit kërkojnë edhe masë të shprehur në mënyrë që objekti dhe shtrirja e pezullimit të jenë të qarta dhe të mos krijohet pasiguri e mëtejshme institucionale*”. Thënë këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë “*rrezikun e dëmit të pariparueshëm – fillimi i afatit kushtetues për zgjedhjen e Presidentit dhe pasoja ex constitutione e shpërndarjes së Kuvendit*”: “*afatin gjashtëmujor të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe rreziku i vakumit funksional*” dhe se masa e përkohshme është në interes publik.
70. Si rrjedhojë, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që të pezullohen “*efektet juridike që varen nga konstatimi i kontestuar i konstituimit, përfshirë rrjedhjen dhe zhvillimin e procedurës kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit, deri në vendimin përfundimtar*”.

Komentet e Lëvizjes Vetëvendosje!

71. Më 18 shtator 2026, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje!, të përfaqësuar nga deputetja Arbërie Nagavci (në tekstin e mëtejshëm: Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!) dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesat KO256/26 dhe KO258/26.
72. Fillimisht, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! thekson se nuk e vënë në dyshim karakterin detyrues të afatit kushtetues për përfundimin e seancës konstituive, mirëpo konsiderojnë se: “*Çështja që duhet zgjidhur është më e ngushtë: nëse kalimi i afatit e shuan kompetencën e deputetëve për ta përfunduar konstituimin dhe i bën vetvetiu të*

pavlefshme të gjitha veprimet e mëvonshme. Një pasojë e tillë nuk parashikohet në Kushtetutë”.

73. Tutje, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! thekson se PDK-ja kishte ushtruar të drejtën e saj të propozimit të kandidatit për nënkryetar dhe se moszgjedhja e kandidates nuk arsyetonte zbatimin e përjashtimit nga paragrafi 148 i Aktgjykimit KO265/25, si dhe se, pas këtij votimi *“PDK-ja u largua nga seanca, nuk mori pjesë në konsultime, nuk e ripropozoi kandidaten për një votim tjetër, nuk propozoi kandidat tjetër dhe, më 13 shtator, njoftoi se do të përmbahej nga propozimi e nga pjesëmarrja deri në nxjerrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese”.*
74. Në këtë drejtim, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! konsideron se të njëjtit nuk kanë shkaktuar pengesë në zgjedhjen e nënkryetarit nga radhët e PDK-së për shkak se: *“Para fillimit të seancës së 13 shtatorit ekzistonte një zotim publik i Grupit Parlamentar më të madh për të votuar kandidaten e PDK-së. Pengesa e mbetur nuk ishte mungesa e votave të deklaruara, por mungesa e propozimit dhe mospjesëmarrja e vetë grupit që gëzonte të drejtën”.*
75. Përkitazi me pranueshmërinë e kërkesave, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! konsideron se parashtruesit e kërkesave kanë identifikuar Vendimin [nr. 11-V-002] të 9 shtatorit 2026, Vendimin procedural të 11 shtatorit 2026, transkriptin e 13 shtatorit 2026, si dhe Vendimin [nr. 11-V-007] për zgjedhjen e Qeverisë, megjithatë theksojnë se: *“Parashtruesit e kërkojnë gjithashtu që Gjykata të përcaktojë në mënyrë të përgjithshme statusin e Legjislaturës XI dhe pasojat e çdo veprimi të ndërmarrë prej saj. Kjo pjesë e kërkesës largohet nga kontrolli i tri akteve të identifikuara dhe merr trajtën e një kërkesë për mendim këshilldhënës mbi një varg skenarësh të ardhshëm”.*
76. Përkitazi me afatin tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! argumenton se: *“Kushtetuta përcakton shprehimisht rastet kur kalimi i një afati sjell shpërndarjen e Kuvendit ose një pasojë tjetër automatike. Nenet 66 dhe 67 nuk parashikojnë se, në ditën e tridhjetë, pushojnë mandatet, shuhet kompetenca për zgjedhjen e organeve të Kuvendit ose bëhen të pavlefshme të gjitha votimet e mëvonshme. Neni 82 i Kushtetutës i përcakton rastet e shpërndarjes së Kuvendit. Tejkalimi i afatit të seancës konstituive nuk është renditur si bazë e shpërndarjes. Një pasojë që e ndërpret mandatin e dalë nga vota e qytetarëve nuk mund të krijohet pa tekst kushtetues të qartë”.*
77. Duke iu referuar rastit të Gjykatës KO124/25, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! thekson se: *“Pas skadimit të afatit fillestar të përcaktuar në KO124/25, Gjykata nuk konstatoi se kompetenca e deputetëve ishte shuar. Ajo caktoi mënyrën dhe afatet për vazhdimin e procesit, i cili përfundoi më vonë. Kjo tregon se skadimi krijon një shkëlqje që duhet korrigjuar, jo një pamundësi të përhershme juridike”.*
78. Në këtë drejtim, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! konsideron se: *“Konstituimi i vonuar mund të vlerësohet në raport me aktet e kontestuara, por nuk krijon vetvetiu një kompetencë për kontroll të pakufizuar të çdo veprimi të mëvonshëm të Kuvendit. Për këto arsye, Gjykata mund të konstatojë se afati nuk është respektuar, pa arritur në përfundimin se zgjedhja e Kryetares, e nënkryetarëve dhe Qeverisë janë automatikisht të pavlefshme”.*

79. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesave se ndërprerjet më të gjata se dyzet e tetë (48) orë janë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! thekson se: *“Mosrespektimi i tij mund të përbëjë shkelje procedurale. Por as Rregullorja dhe as Kushtetuta nuk përcaktojnë se kalimi i dyzet e tetë orëve shuan kompetencën e seancës ose i bën të pavlefshme të gjitha vendimet që pasojnë. Për anulimin e Vendimit nr. 11-V-002 do të duhej të provohej lidhja ndërmjet vonesës dhe një mangësie materiale të zgjedhjes: propozuesi i paautorizuar, votimi i mbyllur, mungesa e kuorumit ose mungesa e shumicës kushtetuese. Kërkesa nuk identifikon asnjë mangësi të tillë”*.
80. Tutje, përkitazi me zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! argumenton se pretendimi për pavlefshmëri mbështetet vetëm në kohën e votimit, duke theksuar se: *“Përderisa skadimi i afatit nuk e shuan kompetencën e deputetëve, ai nuk e zhvleftëson një vendim që përmbush kushtet shprehimore të nenit 67. Përfundim i kundërt do ta linte Kuvendin me detyrim për t’u konstituuar, por pa mjet juridik për ta përmbushur këtë detyrim”*.
81. Përkitazi me vendimin për votimin veç e veç të nënkryetarëve, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! konsideron se: *“Ky ishte vendim procedural për një çështje të parregulluar shprehimisht, jo ndryshim i Rregullores. Rregullorja do të ndryshohej po të ndërrohej norma e përgjithshme; këtu seanca zgjodhi mënyrën e procedimit në një rast konkret”*.
82. Tutje, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! thekson se: *“Analogjia që PDK-ja bën me votimin e hapur ose të fshehtë nuk qëndron. Në rastet KO193/25 dhe KO196/25, forma e votimit prekte një standard të identifikuar nga Kushtetuta, Rregullorja dhe praktika e detyrueshme e seancës. Në çështjen e tanishme, vetë KO265/25 pranon shprehimisht se votimi në paku nuk është detyrim.”*
83. Gjithashtu, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! konsideron se e drejta për të propozuar kandidat nuk nënkupton të drejtën për t’ua imponuar deputetëve për *“përmbajtjen e votës”*, si dhe theksojnë se: *“[...] para vazhdimit të seancës LVV-ja njoftoi se do ta votonte edhe zonjën Çitaku. Kështu, çdo pasojë e votimit të 11 shtatorit mund të tejkalohet menjëherë përmes ripropozimit. PDK-ja vendosi të mos e përdorte këtë mundësi”*.
84. Në këtë drejtim, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! thekson se PDK-ja nuk e humbi të drejtën e propozimit, duke shtuar se: *“Ajo e pezulloi vetë ushtrimin e saj; Kuvendi ruajti pozitën, por nuk pranoi që pezullimi i njëanshëm të bëhej pezullim i institucionit”*.
85. Në vijim, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! i referohet rastit të Gjykatës KO265/25, përkatësisht paragrafit 148, duke theksuar se: *“[...] Kuvendi, përjashtimisht, mund të funksionojë pa njërin anëtar të Kryesisë kur bartësi i së drejtës nuk e ushtron atë ose e përdor mosushtimin për ta penguar procesin, me kusht që Kryesia ta ketë kuorumin.”* Në këtë drejtim, të njëjtit shtojnë se: *“Përjashtimi u bë relevant vetëm më vonë, kur PDK-ja njoftoi se e tërhiqte, përkatësisht e pezullonte kandidaturën, se do të përmbahej nga propozimi dhe se nuk do të merrte pjesë, ndërkohë që LVV-ja kishte vendosur ta votonte kandidaten në rast të ripropozimit”*.
86. Në vazhdim, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!, konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesave për vlerësimin e ligjshmërisë së mosveprimeve të 6 dhe 8

gushtit nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit për shkak të kalimit të afatit prej tetë (8) ditëve nga ato zhvillime.

87. Përkitazi me Vendimin për zgjedhjen e Qeverisë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! thekson se parashtruesit e kërkesës nuk kontestojnë përbërjen e Qeverisë, praninë e kuorumit apo vlefshmërinë e 62 votave dhe konsiderojnë se: *“Ata kërkojnë që një pretendim mbi fazën e mëparshme të konstituimit ta zhvlehtësojë automatikisht vendimin e marrë sipas nenit 95. Kushtetuta nuk përcakton një pasojë të tillë automatike”*.
88. Përkitazi me kërkesën e parashtruesve të kërkesës për masë të përkohshme, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! konsideron se: *“Balanca e interesave anon kundër masës së kërkuar. Dëmi i pretenduar ndaj PDK-së është i kthyeshëm dhe mund të shmanget me paraqitjen e kandidatit. Dëmi nga pezullimi i Kuvendit dhe Qeverisë do të ishte i menjëhershëm, i gjerë dhe do të prekte të gjithë qytetarët”*.
89. Në fund, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! i propozon Gjykatës që: *“a. ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme; b. Të konstatojë se Vendimi nr. 11-V-002 i 9 shtatorit 2026 është marrë në përputhje me kërkesat materiale të nenit 67 paragrafi 2 të Kushtetutës; c. të konstatojë se vendimi procedural i 11 shtatorit 2026 për votimin veç e veç të kandidatëve nuk është në kundërshtim me nenet 67 dhe 76 të Kushtetutës, me Rregulloren e Kuvendit ose me standardet e KO265/25; ç. të konstatojë se PDK-së i është garantuar e drejta e propozimit dhe se moszgjedhja e zonjës Vlora Çitaku në votimin e parë nuk përbënte mosushttrim të kësaj të drejte; d. të konstatojë se, pas votimit të parë, tërheqja e kandidaturës, përmbajtja nga propozimi dhe mospjesëmarrja në seancën e 13 shtatorit përbënin mosushttrim të mëtejshëm të së drejtës në kuptim të paragrafit 148 të KO265/25; e. të marrë parasysh se, para seancës së 13 shtatorit, Grupi Parlamentar i LVV-së kishte njoftuar publikisht se do ta votonte zonjën Vlora Çitaku dhe se mungesa e votimit të dytë erdhi nga mungesa e propozimit aktiv të PDK-së; ë. të konstatojë se Kuvendi ka mundur të vazhdojë funksionimin me pesë anëtarë të Kryesisë dhe me pozitën e PDK-së të lënë të lirë e të rezervuar; f. të konstatojë se Vendimi nr. 11-V-007, i 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë është marrë në përputhje me nenin 95 paragrafi 3 të Kushtetutës, me 62 vota të vlefshme; dhe g. t'i refuzojë kërkesat në pjesën tjetër si të pabazuara.”*

Komentet e dorëzuara nga deputeti z. Burim Ramadani

90. Më 18 shtator 2026, z. Burim Ramadani, deputet i zgjedhur nga AAK, dorëzoi në Gjykatë komentet e tij lidhur me kërkesat KO256/26 dhe KO258/26.
91. Deputeti z. Burim Ramadani konsideron se data 7 gusht 2026 përbënte fundin e afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit. Në këtë drejtim, deputeti z. Burim Ramadani thekson se, më 6 gusht 2026, është mbajtur Seanca Konstituive e Legjislaturës XI, gjatë të cilës grupi më i madh parlamentar nuk ka propozuar kandidatin për Kryetar të Kuvendit, pavarësisht se, sipas tij *“propozimi i kandidatit për Kryetar të Kuvendit nga grupi më i madh parlamentar nuk është thjesht një mundësi politike, por pjesë e mekanizmit kushtetues të konstituimit.”*. Tutje, deputeti z. Burim Ramadani shton se Seanca Konstituive vazhdoi më 8 gusht 2026 që, sipas tij, paraqet vazhdim të Seancës Konstituive pas skadimit të afatit, ku grupi më i madh parlamentar nuk propozoi kandidat për Kryetar të Kuvendit. Në lidhje me këtë, deputeti z. Burim Ramadani shton se *“Seanca është ndërprerë. Pas kësaj ndërprerjeje, sipas dokumentacionit të paraqitur, nuk ishte respektuar detyrimi procedural për vazhdimin e seancës brenda 48 orëve. Kjo krijon një*

çështje të veçantë kushtetuese dhe procedurale: jo vetëm që afati 30 ditësh kishte skaduar, por edhe mekanizmi procedural i parapare për vazhdimin e Seancës Konstituive nuk ishte ndjekur”.

92. Më tej, deputeti z. Burim Ramadani, para Gjykatës, thekson se zgjedhja e Kryetares së Kuvendit përmes Vendimit [nr. 11-V-002] të 9 shtatorit 2026, *“ka ndodhur 33 ditë pas skadimit të afatit kushtetues prej 30 ditësh”.*
93. Deputeti z. Burim Ramadani thekson se, më 11 shtator 2026, pas votimit veç e veç, u zgjodh kandidati i propozuar për nënkryetar të Kuvendit nga grupi më i madh parlamentar ndërkaq që kandidatja e propozuar nga PDK nuk mori shumicën e nevojshme të votave. Sipas deputetit z. Burim Ramadani, *“Kryetarja e Kuvendit ka interpretuar këtë sjellje si refuzim të ushtrimit të së drejtës për propozim dhe ka bërë referim në paragrafin 148 të Aktgjykimit KO265/25.”* Tutje, deputeti z. Burim Ramadani shton se, më 13 shtator 2026, u zgjodhën nënkryetarët e tjerë të Kuvendit dhe se pavarësisht faktit se ende nuk ishte zgjedhur nënkryetarja nga grupi i dytë më i madh parlamentar - PDK, Kryetarja e Kuvendit konstatoi se Kuvendi ishte konstituuar.
94. Në këtë aspekt, deputeti z. Burim Ramadani shton se *“[...] Kuvendi i Legjislaturës XI, përmes mosveprimit të grupit më të madh parlamentar dhe të Kryesuesit të Seancës Konstituive, nuk është konstituuar brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës dhe se, duke vepruar kështu, ka shkelur paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës, si pasojë e moszbatimit të Aktgjykimeve KO124/25, KO193/25 dhe KO196/25, KO265/25 dhe KO325/25.”*
95. Përkitazi me Vendimin për zgjedhjen e Qeverisë, përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë, deputeti z. Burim Ramadani thekson: *“Vlerësoj se Vendimi nr. 11-V-007 i 13 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës është nxjerrë nga një Kuvend që nuk është i konstituuar dhe, rrjedhimisht, është në kundërshtim me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës, nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati], nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] dhe nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, si dhe me Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese”.*
96. Deputeti z. Burim Ramadani shton *“Në vlerësimin tim, ekziston këtu një çështje themelore e rendit kushtetues. Nëse një shumicë ose një grup parlamentar kontribuon në krijimin e një situatë procedurale në kundërshtim me Kushtetutën dhe më pas përdor pikërisht ato situata si bazë për të përfunduar procesin në mënyrë tjetër nga ajo që do të kishte ndodhur brenda afatit kushtetues, krijohet një problem i veçantë i sundimit të ligjit. Nuk mund të jetë parim kushtetues që një shkelje procedurale të krijojë avantazh juridik për akterin që e ka shkaktuar atë shkelje. Përndryshe, afatet kushtetuese do të bëheshin të manipulueshme: mosveprimi do prodhonte një situatë faktike dhe kjo situatë faktike më pas do të përdorej si bazë për të justifikuar veprimin e mëvonshëm”.*
97. Në fund, deputeti z. Burim Ramadani thekson se është i vetëdijshëm se *“Funksionalizimi i Kuvendit dhe i Qeverisë është interes shtetëror dhe publik. Megjithatë, urgjenca institucionale nuk mund të përdoret si arsye për të relativizuar kushtetutshmërinë.”* Sipas deputetit z. Burim Ramadani, interesi publik kërkon stabilitet institucional, siguri juridike, respektim të vendimeve të Gjykatës, qartësi mbi kompetencat e organeve, respektim të ndarjes së pushteteve dhe shmangie të precedentëve që mund të lejojnë tejkalimin e afateve

kushtetuese. Rrjedhimisht, deputeti z. Burim Ramadani argumenton se “Kushtetuta nuk duhet të jetë më pak detyruese në momentin kur ekziston nevoja për funksionalizim të shpejtë institucional. Përkundrazi, pikërisht në rrethana të tilla duhet të jetë më e qartë se:

- afatet kushtetuese nuk janë fakultative;
- Aktgjykimet e Gjykatës nuk janë rekomandime;
- kompetencat institucionale nuk mund të zgjerohen përmes shumicës politike;
- një shkelje e mëparshme nuk duhet të prodhojë avantazh juridik për shkelësin; dhe
- funksionalizimi i institucioneve duhet të bëhet brenda Kushtetutës, jo jashtë saj”.

Komentet e dorëzuara nga Grupi Parlamentar Multietnik

98. Më 18 shtator 2026, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik, të përfaqësuar nga deputeti Artan Asllani, dorëzuan në Gjykatë komentet e tyre lidhur me kërkesat KO256/26 dhe KO258/26.
99. Fillimisht, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik theksojnë se “vlerësimi kushtetues i rasteve KO256/26 dhe KO258/26 duhet të marrë parasysh edhe pozitën kushtetuese të deputetëve të komuniteteve, vlefshmërinë e propozimit dhe zgjedhjes së nënkryetares së tyre, si dhe pasojat që do të kishte pezullimi ose zhvleftësimi i institucioneve për përfaqësimin efektiv të komuniteteve joshumicë.”.
100. Deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik argumentojnë se nuk e kanë kontestuar në asnjë moment të drejtën e PDK-së për propozim të kandidatit për nënkryetar të Kuvendit, nuk kanë mbështetur bartjen e kësaj pozite te ndonjë grup tjetër parlamentar dhe se ishin të gatshëm ta votonin znj. Vlora Çitaku në vazhdimin e seancës së 13 shtatorit 2026, nëse PDK do të ishte e pranishme dhe do të ripropozonte kandidaturën e saj. Në këtë aspekt, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik konsiderojnë se “Në këto rrethana, vazhdimi i konstituimit me zgjedhjen e nënkryetarëve nuk e cenoi përfaqësimin e PDK-së. Ai mundësoi që të drejtat e grupeve tjera parlamentare dhe të deputetëve të komuniteteve të mos mbeteshin të pezulluara për shkak të vendimit të një grupi tjetër për të mos marrë pjesë në procedurë.”.
101. Më tej, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik theksojnë se nuk e kundërshtojnë deklarinë e 13 shtatorit 2026 të PDK-së lidhur me tërheqjen e përkohshme nga propozimi i kandidatit për nënkryetar të Kuvendit, por që, sipas tyre, “Megjithatë, cilësimi i tërheqjes si i përkohshëm nuk e ndryshon faktin se, në momentin kur Kuvendi vazhdoi punimet, nuk kishte kandidaturë aktive të PDK-së mund të hidhej në votim.”.
102. Përkitazi me çështjen e konstituimit të Kuvendit brenda afatit kushtetues, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik theksojnë se “nga karakteri detyrues i afatit nuk rrjedh automatikisht se, pas kalimit të tij, humbin kompetencën për ta përfunduar konstituimin ose se çdo vendim i mëvonshëm bëhet vetvetiu i pavlefshëm.”, dhe se “Kushtetuta nuk përcakton se kalimi i afatit tridhjetëditor sjell automatikisht përfundimin e mandateve të deputetëve, shpërndarjen e Kuvendit ose shuarjen e kompetencës për zgjedhjen e organeve të Kuvendit.”. Në lidhje me këtë, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik shtojnë se “Neni 82 i Kushtetutës i përcakton rastet e shpërndarjes së Kuvendit. Tejkalimi i afatit të Seancës Konstituive nuk është përcaktuar shprehimisht si shkak për shpërndarje. Një interpretim që ua heq deputetëve kompetencën për ta përfunduar konstituimin pas kalimit të afatit do ta bënte të pamundur përmbushjen e vetë detyrimit kushtetues. Për deputetët e komuniteteve, një interpretim i tillë do të kishte pasojë

veçanërisht të rëndë. Ai do ta zhvlehtësonte përfaqësimin e tyre në Kryesinë e Kuvendit për shkak të vonesave ose mosmarrëveshjeve që nuk janë krijuar dhe nuk kanë mundur të zgjidhen nga ata.”.

103. Tutje, përmes komenteve të dorëzuara, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik konsiderojnë se *“Edhe rregulli për vazhdimin e Seancës Konstituive brenda dyzet e tetë orëve duhet të respektohet. Por as Kushtetuta dhe as Rregullorja nuk përcaktojnë se kalimi i këtij afati e shuan mandatin e deputetëve ose e bën juridikisht të pamundur vazhdimin e seancës.”.* Lidhur me këtë, sipas tyre *“Vonesa procedurale mund të konstatohet, por ajo nuk duhet të përdoret për ta zhvlehtësuar automatikisht ushtrimin e mëvonshëm të të drejtave të deputetëve dhe të komuniteteve.”.*
104. Lidhur me çështjen e konstituimit të Kuvendit dhe Vendimit të kontestuar për votimin e Qeverisë, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik argumentojnë se (i) pozita e paplotësuar e një nënkryetari nuk e privoi Kuvendin nga kompetenca për të funksionuar, pasi Kryesia e Kuvendit kishte kuorumin e nevojshëm; (ii) deputetët komuniteteve kishin mandat të plotë kushtetues dhe të drejtë të merrnin pjesë në zgjedhjen e Qeverisë; dhe (iii) vota e tyre nuk mund të konsiderohet e pavlefshme për shkak të mosplotësimit të një pozite që i takonte një grupi tjetër parlamentar. Rrjedhimisht, sipas deputetëve të Grupit Parlamentar Multietnik *“Vendimi nr. II-V-007 për zgjedhjen e Qeverisë duhet të konsiderohet i vlefshëm dhe kërkesa KO258/ 26 duhet të refuzohet si e pabazuar.”.*
105. Përkitazi më kërkesën e parashtruesve të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik konsiderojnë se: *“Masa e përkohshme do ta pezullonte, në praktikë, edhe përfaqësimin e komuniteteve në Kryesinë e Kuvendit, ndonëse zgjedhja e nënkryetares së tyre nuk është rezultat i asnjë veprimi ose mosveprimi të PDK-së. Një masë e tillë do të ishte joproporcionale, sepse do prekte institucione dhe pozita që janë plotësuar në mënyrë të rregullt për ta mbrojtur një pozitë që tashmë është lënë e lirë dhe e rezervuar. Ruajtja e pozitës së nënkryetarit të PDK-së është realizuar pa nevojën e pezullimit të Kuvendit. Për këto arsye, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.”.*
106. Në fund, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik i propozojnë Gjykatës që: *“ta refuzojë kërkesën për masë; të konstatojë se moszhvillimi i një votimi tjetër për kandidaten e PDK-së ka ardhur nga mungesa e një propozimi aktiv dhe nga mospjesëmarrja e PDK-së në vazhdimin e seancës; të konstatojë se e drejta e PDK-së është ruajtur, sepse pozita e nënkryetarit që i takon këtij grupi ka mbetur e lirë dhe e rezervuar; të konstatojë se propozimi dhe zgjedhja e zonjës Emilija Rexhepi janë bërë në përputhje me nenin 67 paragrafi 4 të Kushtetutës dhe se zgjedhja e saj nuk mund të cenohet nga mosplotësimi i pozitës së një grupi tjetër parlamentar; të konstatojë se Vendimi nr. II-V-007 për zgjedhjen e Qeverisë është marrë me shumicën e kërkuar kushtetuese dhe nuk është paraqitur asnjë mangësi e pavarur në procedurën e miratimit të tij.”.*

Komentet e dorëzuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës

107. Më 18 shtator 2026, deputetët e LDK-së, të përfaqësuar nga deputetja Jehona Lushaku-Sadriu, dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesat KO256/26 dhe KO258/26.
108. Fillimisht, deputetët e LDK-së theksojnë se *“në dritën e Aktgjykimit KO124/25 dhe duke marrë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës në Aktgjykimin KO72/26 dhe KO74/26, vlerësojmë se Gjykata duhet dhënë një interpretim të drejtpërdrejtë dhe përfundimtar se*

a vazhdon detyrimi i deputetëve për konstituim pas skadimit të afatit 30 ditor; nën çfarë procedure kushtetuese duhet të vazhdohet procesi i konstituimit në raste të tilla; si dhe cili është mekanizmi kushtetues që shërben si udhërrëfyes në rastet kur Presidenti ose kryesuesi i seancës konstitutive e pamundëson mbledhjen/vazhdimin e seancës konstitutive brenda afateve të përcaktuara kushtetuese.”.

109. Deputetët e LDK-së konsiderojnë se Gjykata duhet të japë një interpretim të drejtpërdrejtë dhe përfundimtar mbi efektin juridik të tejkalimit të afatit tridhjetë (30) ditor lidhur me vlefshmërinë e akteve konstituive të miratuara nga Kuvendi i konstituuar pas skadimit të afatit tridhjetë (30) ditor. Në këtë drejtim, deputetët e LDK-së shtojnë “[...] a janë efektet e një konstatimi të papajtueshmërisë *ex nunc* apo *ex tunc* në kuptim të nenit 116(3) të Kushtetutës së Kosovës, dhe a duhet bërë dallim ndërmjet vetë akteve konstituive dhe vendimeve të ndërmarra më pas mbi bazën e tyre?”. Tutje, sipas deputetëve të LDK-së, përveç vlerësimit lidhur me çështjen e votimit të Kryetares së Kuvendit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, Gjykata duhet të ofrojë një interpretim të ndarë e të drejtpërdrejtë dhe përfundimtar mbi efektin juridik të votimit të Qeverisë nga Kuvendi, pasi “*Legjitimiteti kushtetues për ushtrimin e pushtetit ekzekutiv është fundamental si dhe për funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës*”.
110. Më tej, përkitazi me çështjen aplikimit të standardit të paragrafit 148 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO265/25, deputetët e LDK-së konsiderojnë se Gjykata duhet të ofrojë “*interpretim të drejtpërdrejtë dhe përfundimtar lidhur me kriteret objektive që duhet të plotësohen për aplikimin e përkatësisht për të konstatuar se një grup parlamentar nuk e ka ushtruar të drejtën kushtetuese të propozimit të kryetarit të kuvendit apo të një anëtarit të Kryesisë. Në veçanti, a mjafton mungesa e deputetëve të GP nga seanca konstituive; a kërkohet refuzim i qartë i GP, a nevojitet paralajmërim paraprak apo ndonjë kriter apo udhëzim tjetër konkret; dhe cili organ është kompetent ta konstatojë përfundimisht këtë mosushtrim të së drejtës?*”.
111. Tutje, deputetët e LDK-së argumentojnë se Kushtetuta është e qartë lidhur me pasojat juridike të moszgjedhjes së Qeverisë, moszgjedhjes së Presidentit si dhe moszgjedhjes brenda afatit të institucioneve të pavarura kushtetuese. Megjithatë, sipas deputetëve të LDK-së “*Kuvendi i Kosovës mbetet i vetmi institucion për të cilin është sqaruar afati kushtetues për konstituim, por nuk është sqaruar pasoja juridike e mosrespektimit të këtij afati. Prandaj, vlerësimi nga gjykata i pasojave kushtetuese të moskonstituimit brenda afatit, në këto rrethana është i domosdoshëm për mbrojtjen e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe funksionimin demokratik të institucioneve*”.
112. Në këtë drejtim, deputetët e LDK-së konsiderojnë se është e qartë se moskonstituimi i Kuvendit brenda afatit kushtetues, nuk mund ta shpërndajë Kuvendin, për shkak se rrethanat e shpërndarjes së Kuvendit janë shprehimisht të listuara në nenin 82 të Kushtetutës, mirëpo theksojnë se: “[...] mungesa e një sqarimi kushtetues se cilat janë pasojat kushtetuese të tejkalimit të afatit të përcaktuar me një aktgjykim të kësaj gjykate, e vendosë Kuvendin në situatë të pasigurisë juridike rreth veprimeve të mëtejme në ushtrimin e mandatit të tij, përfshirë për çështje të interesit madhor”.
113. Gjithashtu, deputetët e LDK-së theksojnë se: “*Këto paqartësi, krijojnë pasiguri të madhe juridike në çdo vendimmarrje të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në raportet institucionale me degët e tjera të pushtetit, në ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse ndaj Qeverisë, në çështje të sigurisë kombëtare, të politikës së jashtme dhe çdo çështje tjetër që bie në fushëveprimtarinë e Kuvendit. [...] Prandaj, është esenciale që Gjykata*

Kushtetuese të jep sqarimet e nevojshme, në funksion të mbrojtjes së rendit kushtetues të Republikës së Kosovës”.

114. Përkitazi me kërkesën e parashtruesve të kërkesave për masë të përkohshme, deputetët e LDK-së argumentojnë se “[...] pezullimi i rrjedhjes së afateve deri në sqarimin përfundimtar të kësaj çështje është i domosdoshëm për të parandaluar pasoja të pariparueshme”.
115. Në këtë drejtim, deputetët e LDK-së, theksojnë se: *“Vendosja e masës së përkohshme për pezullimin e rrjedhjes së afatit 60 ditor për zgjedhjen e Presidentit si dhe çdo afati tjetër relevant që lidhet me funksionimin e Kuvendit është në interes publik të vendit, për të mundësuar, siç ka theksuar Gjykata Kushtetuese: “që ai të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar”.*”
116. Në fund, deputetët e LDK-së i propozojnë Gjykatës që: *“I. Të shpallë kërkesat e bashkuara KO256/26 dhe KO258/26 të pranueshme; II. Të sqarojë pasojat juridike të konstituimit të Kuvendit jashtë afatit të caktuar në nenin 66 (1) të Kushtetutës dhe Aktgjykimin KO 124/25; III. Të sqarojë përputhshmërinë me kushtetutën të akteve të miratuara nga Kuvendi i konstituuar jashtë afatit 30 ditor; Të sqarojë veprimet që mund të ndërmarrin deputetët në rastet kur u pamundësohet ushtrimi i mandatit dhe konstituimi i kuvendit brenda afatit për shkak të mosthirrjes së seancave nga kryesuesi i kuvendit; V. Të sqarojë kriteret në bazë të të cilave determinohet mosushtrimi i së drejtës së propozimit nga grupet parlamentar të kryetarit apo nënkryetarëve të Kuvendit; VI. Të miratojë masën e përkohshme.”.*

Komentet e dorëzuara nga Kryetarja e Kuvendit

117. Më 18 shtator 2026, Kryetarja e Kuvendit dorëzoi në Gjykatë komentet e saj lidhur me kërkesat KO256/26 dhe KO258/26.
118. Fillimisht, Kryetarja e Kuvendit thekson se *“Kuvendi nuk e konteston se afati tridhjetëditor për përfundimin e seancës konstituive është detyrues dhe se ky afat nuk është respektuar ne rastin e Legjislaturës XI. (çështja juridike që duhet zgjidhur është pasoja që prodhon kalimi i tij. As neni 66, as neni 67 dhe as ndonjë dispozitë tjetër e Kushtetutës nuk parashikon se, me përfundimin e tridhjetë ditëve, shuhen mandatet e deputetëve, humbet kompetenca për ta përfunduar seancën, shpërndahet Kuvendi automatikisht, shkaktohen zgjedhje ose bëhen vetvetiu të pavlefshme të gjitha veprimet e mëvonshme.”.* Sipas Kryetares së Kuvendit *“Edhe vetë parashtruesit në paragrafin 18 të kërkesës, pranojnë se kalimi i afatit nuk e shuan detyrimin për konstituim; në paragrafin 49 pohojnë se pasoja juridike nuk është zgjidhur nga jurisprudenca; ndërsa në paragrafin 54 pranojnë se neni 66 nuk përcakton shpërndarje automatike. Këto pohime nuk përputhen me cilësimin e afatit si "prekluziv" në paragrafin 55 dhe me kërkesën që aktet e mëvonshme të trajtohen si automatikisht të pavlefshme.”.*
119. Kryetarja e Kuvendit përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë argumenton se detyrimi për të vepruar brenda afatit nuk mund të shndërrohet, pas shkeljes së tij, në ndalim kushtetues për ta korrigjuar shkeljen. Sipas Kryetares së Kuvendit *“Interpretimi i kundërt do ta përjetësonte bllokadën dhe do ta bënte të pamundur realizimin e mandatit të dalë nga zgjedhjet.”.*

120. Në këtë drejtim, Kryetarja e Kuvendit konsideron se (i) zgjedhja e Kryetares së Kuvendit më 9 shtator 2026 i ka plotësuar kërkesat materiale nga paragrafi 2 i nenit 67 të Kushtetutës pasi propozimi është bërë nga grupi më i madh parlamentar, votimi ka qenë i hapur dhe kandidatja ka marrë gjashtëdhjetë e dy (62) vota të deputetëve; (ii) Kushtetuta dhe Rregullorja e punës e Kuvendit nuk imponojnë votimin e kandidatëve për nënkryetarë të Kuvendit në pako; (iii) PDK-së i është garantuar dhe i është mundësuar ushtrimi i të drejtës së propozimit dhe se dështimi i një kandidature nuk është mohim i të drejtës së propozimit dhe as nuk mund të shndërrohet në detyrim të deputetëve për ta zgjedhur kandidatin e caktuar; (iv) pozita e nënkryetarit të Kuvendit që i takon PDK-së nuk i është dhënë asnjë grupi tjetër dhe vazhdon të mbetet e rezervuar dhe se *“shpallja e konstituimit nuk e ka shuar dhe as transferuar të drejtën e PDK-së; ajo ka penguar që mosushtrimi i përkohshëm e i njëanshëm i kësaj të drejte ta bllokojë për një kohë të pacaktuar tërë institucionin.”*; (v) në seancën e 13 shtatorit, PDK-ja nuk ishte e pranishme dhe nuk paraqiti kandidat për nënkryetar.”.
121. Kryetarja e Kuvendit thekson se *“Mosparaqitja e kandidatit më 6 dhe 8 gusht 2026 nga LVV, kërkesat për kohë shtesë dhe ndërprerjet e seancës nga kryesuesi i seancës nuk janë ligje ose vendime të miratuara nga Kuvendi. Për atë që paraqitet kërkojnë që këto mosveprime të vlerësohen si Objekte të pavarura, KO256/26 nuk përputhet me objektin e përcaktuar në nenin 113 paragrafi 5 dhe, sidoqoftë, është paraqitur më shumë se tetë ditë pas tyre.”*.
122. Tutje, Kryetarja e Kuvendit konsideron se rasti i Gjykatës KO124/25, rastet e bashkuara KO193/25 dhe KO196/25, rasti KO265/25 dhe rasti KO325/25 kanë pasur për objekt të çështjeve akte të një legjislature tjetër, kandidatura të tjera dhe një rrjedhë tjetër faktike, dhe se, rrjedhimisht, *“nuk ekziston identiteti i objektit dhe i rrethanave që do t'i bënte këto raste të njëjta me një çështje të gjykuar më parë.”*. Lidhur me këtë, Kryetarja e Kuvendit shton *“Në paragrafin 146 të KO265/25, Gjykata ka ritheksuar rregullin se seanca konstituive përmbillet pas zgjedhjes së Kryetarit dhe nënkryetarëve. Mirëpo, në paragrafin 148, ajo ka pranuar se “Kuvendi përjashtimisht, do të mund të vazhdojë funksionimin” pa njërin anëtar të Kryesisë, kur plotësohen kushtet e përshkruara aty. Rregulli dhe përjashtimi janë pjesë e të njëjtit standard detyrues. Po kështu, paraqitja nuk mund ta cilësojë si res judicata pasojën e skadimit të afatit, kur vetë pohojnë në paragrafin 49 të kërkesës se kjo pasojë nuk është përcaktuar më parë. Një çështje që pretendohet se ka mbetur e pazgjidhur nuk mund, njëkohësisht, të jetë çështje e gjykuar përfundimisht.”*. Duke iu referuar aktgjykimeve të Gjykatës në rastet e lartpërmendura, Kryetarja e Kuvendit argumenton se *“Në rastin e tanishëm duhet të zbatohen standardet e përgjithshme të atyre aktgjykimeve, por jo të bartet automatikisht një pasojë juridike nga rrethana faktike dhe operative që nuk janë identike. Qasja e drejtë ndaj precedentit është, pra, kjo: të zbatohen besnikërisht standardet e vendosura, por të vlerësohet nëse faktet e reja hyjnë në rregullin e përgjithshëm apo në përjashtimin e përcaktuar nga vetë Gjykata. Kjo është zbatim i jurisprudencës, jo shmangie prej saj.”*.
123. Përkitazi me çështjen e konstituimit të Kuvendit, Kryetarja e Kuvendit thekson se procesi i konstituimit të Legjislaturës XI nuk ka përfunduar brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Megjithatë, sipas Kryetares së Kuvendit, *“Çështja e pasojës juridike të këtij parimi është trajtuar, në një formë, në rastin nr. KO119/14, konkretisht në paragrafin 126, ku theksohet se: “Gjykata vëren se askund në Kushtetutë nuk parashihet që dështimi në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit do të shkaktonte mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare.”*. Lidhur me këtë, as në vitin 2014, as në vitin 2025 e as në vitin 2026, Kuvendi nuk është konstituuar brenda afatit të paraparë kushtetues, si pasojë e mosmarrëveshjeve politike

ndërmjet grupeve parlamentare kanë fituar vende në Kuvendin e Kosovës. Pra, pasoja juridike e tejkalimit të afatit kushtetues për konstituimin e Kuvendit nuk e çon vendin në zgjedhje. Gjithashtu, në asnjë normë kushtetuese nuk përcaktohet se tejkalimi i këtij afati, si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve politike, do t'i bënte të pavlefshme veprimet e tjera kushtetuese të ndërmarra pas konstituimit të Kuvendit.”.

124. Tutje, Kryetarja e Kuvendit argumenton se legjitimiteti demokratik i përfaqësuesve të popullit për t'i dhënë jetë funksionimit kushtetues të institucioneve, pas kalimit të afatit kushtetues për konstituimin e Kuvendit, nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet kushtetuese përmbajtjesore që kanë quar në krijimin dhe funksionimin kushtetues të organeve legislative dhe ekzekutive. Kryetarja e Kuvendit shton se *“[...] ky afat kushtetues nuk është respektuar me arsyetimin e drejtë se duhej gjetur një marrëveshje politike që i zbaton me përpikëri normat kushtetuese, të cilat çojnë në themelimin e institucioneve kushtetuese dhe në funksionimin e tyre të vazhdueshëm gjatë një mandati kushtetues.”.*
125. Sipas komenteve të dorëzuara nga Kryetarja e Kuvendit, mungesa e përcaktimit të pasojës juridike në rast të konstituimit të Kuvendit pas afatit kushtetues, e dallon këtë afat nga (i) afati për zgjedhjen e Qeverisë, i përcaktuar në nenin 95 të Kushtetutës, ku *“dështimi i mandatarit për t'u zgjedhur brenda afatit 15-ditor sjell, pas dështimit të parë, caktimin e një mandatarit tjetër nga ana e Presidentit dhe, pas dështimit të mandatarit të dytë, shpalljen e zgjedhjeve.”;* dhe (ii) paragrafi 1 i nenit 82 të Kushtetutës që përcakton shprehimisht se skadimi i afatit gjashtëdhjetë (60) ditor pas fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit prodhon një pasojë juridike të caktuar, përkatësisht shpërndarjen e Kuvendit. Në këtë aspekt, Kryetarja e Kuvendit shton se *“Këta dy shembuj dëshmojnë se, kur kushtetutëbërësit kanë synuar që tejkalimi i afateve të prodhojë pasoja juridike, ata i kanë përcaktuar ato drejtpërdrejt në tekstin e Kushtetutës. Kjo nënkupton se moscaktimi në tekstin e Kushtetutës i pasojave të tilla pas skadimit të afatit 30-ditor për konstituimin e Kuvendit ka qenë i qëllimshëm nga ana e kushtetutëbërësve. Prandaj, shpikja e pasojave juridike më shumë se tetëmbëdhjetë vjet pas miratimit të Kushtetutës, siç po kërkohet nga parashtruesit, jo vetëm që do të përbënte një importim tërësisht të jashtëm ndaj tekstit të saj, por edhe një deformim të papranueshëm të qëllimit të vetë kushtetutëbërësve, të cilët, dëshmohej nga dy shembujt e lartcekur, kanë ditur shumë mirë t' i përcaktojnë pasojat e tejkalimit të afateve kur e kanë vlerësuar të arsyeshme që tejkalimi të prodhojë pasoja të tilla”.*
126. Kryetarja e Kuvendit konsideron se nenet 66 dhe 67 të Kushtetutës nuk e ndalojnë vazhdimin e seancës. Sipas Kryetares së Kuvendit *“Neni 66 përcakton kohëzgjatjen e mandatit të Kuvendit, ndërsa neni 82 përcakton rastet në të cilat Kuvendi shpërndahet ose mund të shpërndahet. Asnjëra prej këtyre dispozitave nuk e përcakton skadimin e afatit për përfundimin e seancës konstituive, si të tillë, si shkak për shpërndarjen e Kuvendit. Prandaj, një pasojë e tillë nuk mund të krijohet përmes analogjisë, veçanërisht kur prek drejtpërdrejt mandatin e dalë nga zgjedhjet dhe funksionimin e rendit kushtetues.”.* Në këtë drejtim, Kryetarja e Kuvendit shton se edhe vetë parashtruesit e kërkesave theksojnë se, edhe pas skadimit, deputetët vazhdojnë ta kenë detyrimin për konstituim të Kuvendit. Për më tepër, sipas Kryetares së Kuvendit, *“[...] humbja e kompetencës për ta korrigjuar shkeljen e afatit do të binte në kundërshtim me vetë qëllimin e afatit. Përkatësisht, vendosja e afatit 30 ditor në Kushtetutë e ka për qëllim mosvonimin e konstituimit të Kuvendit dhe, rrjedhimisht, formimit të institucioneve të dala nga Kuvendi, përfshirë edhe Qeverinë, sa më shpejt. Mirëpo nëse deputetët nuk do të kishin kompetencën për ta korrigjuar shkeljen, për të konstituuar Kuvendin me vonesë, kjo do të shkaktonte edhe më shumë vonesa në konstituimin e Kuvendit, sidomos nëse*

konstatohet se tejkalimi i afatit 30 ditor shkakton zgjedhje të reja. Arritja e qëllimit të afatit, konstituimi sa më i shpejtë i Kuvendit, kërkon që, edhe nëse tejkalohej afati 30 ditor, deputetët të vazhdojnë kenë të drejtë të kryejnë, sa më parë, hapat e nevojshëm për konstituim.”.

127. Në këtë drejtim, sipas Kryetares së Kuvendit, *“Në rastin aktual, Gjykata mund të konstatojë se afati nuk është tejkaluar. Por nuk ka bazë tekstuale në Kushtetutë ose precedent që nga ky konstatim të nxirret automatikisht pavlefshmëria e zgjedhjes së Kryetares, shpërndarja e Kuvendit, pavlefshmëria e Qeverisë ose pamundësia për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm kushtetues.”.* Tutje, Kryetarja e Kuvendit konsideron se (i) legjitimiteti demokratik i përfaqësuesve të popullit dhe vullneti i tyre për t'i krijuar institucionet kushtetuese *“kanë rëndësi më të madhe se sa mosrespektimi i vetëm një norme kushtetuese që përcakton një afat kushtetues.”;* (ii) në doktrinën juridike dhe kushtetuese tejkalimi i një afati kushtetues nuk nënkupton shkelje kushtetuese në kuptimin e plotë të fjalës; dhe (iii) *“Nëse tejkalimi i afatit do të përdorej si argument për të bërë të pavlefshme çdo përpjekje të mëvonshme për të përfunduar procesin, rezultati do të ishte thellësisht paradoksal, një shkelje procedurale do të prodhonte një gjendje edhe më të agravuar të bllokimit institucional e kushtetues, ku do të vihej në rrezik cenimi i rendit kushtetues, dhe juridik dhe rendit publik”.*
128. Lidhur me pretendimin e parashtruesve të kërkesave për mosrespektim të afatit procedural për vazhdimin e seancës çdo dyzet e tetë (48) orë, Kryetarja e Kuvendit argumenton se neni 76 i Kushtetutës nuk përcakton se çdo tejkalim procedural e bën automatikisht të pavlefshëm çdo vendim të marrë më vonë. Kryetarja e Kuvendit shton se *“Për të arritur deri te pavlefshmëria e Vendimit nr. II-V-002, nuk mjafton vetëm konstatimi se ndërmjet vazhdimëve të seancës ka kaluar më shumë se dyzet e tetë orë. Duhet të vlerësohet nëse kjo vonesë e ka cenuar në mënyrë materiale procedurën kushtetuese zgjedhjes, duke prekur bartësin e të drejtës propozimit, njoftimin dhe pjesëmarrjen e deputetëve, formën e votimit, kuorumin ose shumicën e nevojshme. Një cenim i tillë nuk është dëshmuar.”* Tutje, Kryetarja e Kuvendit konsideron se *“Për aq sa pretendimi dyzetetetëorësh mbështetet në ndërprerjet e 6 dhe 8 gushtit ose në mosveprimin deri më 4 shtator, ai ka të bëjë me rrethana të ndodhura jashtë afatit tetëditor dhe para zgjedhjes së Kryetares aktuale. Ato mund të konstatojnë vonesë institucionale, por nuk mund të shndërrohen në shkak automatik për anulimin e një zgjedhjeje që, në përmbajtje, i ka plotësuar nenet 67 dhe 76.”.*
129. Më tej, përkitazi me Vendimin për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit, kjo e fundit konkludon se *“Më 9 shtator 2026, të gjitha kërkesat materiale janë përmbushur: kandidatja është propozuar nga grupi më i madh; votimi ka qenë i hapur; në seancë kanë qenë të pranishëm 102 deputetë; dhe kandidatja ka 62 vota për.”.* Në këtë aspekt, Kryetarja e Kuvendit argumenton se skadimi i afatit nuk e ka shuar mandatin ose kompetencën e deputetëve dhe as detyrimin kushtetues për konstituimin e Kuvendit. Sipas Kryetares së Kuvendit *“Rrjedhimisht, nuk mund ta bëjë vetvetiu të pavlefshëm një vendim që i ka plotësuar kërkesat shprehimore të nenit 67 paragrafi 2. Përfundimi i kundërt do të krijonte një situatë pa dalje kushtetuese dhe do ta cenonte sigurinë juridike: Kuvendi do të kishte detyrim të vazhdueshëm për t'u konstituuar, por çdo vote për përmbushjen e këtij detyrimi do të ishte e pavlefshme. Kushtetuta nuk mund të interpretohet në mënyrë që detyrimi dhe kompetenca të përjashtojnë njëri-tjetrin.”.*
130. Tutje, përkitazi me Vendimin për votimin e veç e veç të nënkryetarëve, Kryetarja e Kuvendit argumenton se: *“Më 11 shtator 2026, mënyra e votimit nuk është përcaktuar në mënyrë*

të njëanshme nga Kryetarja. Çështja i është paraqitur seancës dhe Kuvendi ka vendosur me 71 vota për, 10 kundër dhe një abstenim. Vendimi është marrë për një çështje për të cilën Kushtetuta dhe Rregullorja nuk përcaktojnë formë tjetër të detyrueshme”.

131. Në këtë drejtim, Kryetarja e Kuvendit konsideron se: *“Votimi në pako mund të jetë praktikë e përshtatshme kur ka marrëveshje politike. Mirëpo, ai mund ta vendosë deputetin para zgjedhjes që ta mbështesë një kandidat që nuk e përkrah, vetëm për ta votuar një kandidat tjetër. Kushtetuta nuk e imponon këtë kufizim të mandatit të lirë”.*
132. Në vazhdim, lidhur me të drejtën e PDK-së për propozim të nënkryetarit të Kuvendit, Kryetarja e Kuvendit thekson e PDK në fazën e parë e ka ushtruar të drejtën e saj duke e propozuar znj. Vlora Çitaku dhe se: *“Në këtë fazë, dështimi ka ardhur nga rezultati i votimit dhe jo nga mosushtrimi i së drejtës së propozimit”.*
133. Në këtë drejtim, Kryetarja e Kuvendit shton se: *“Në fazën e dytë, pozita ka mbetur e lirë dhe e drejta e PDK-së për propozim ka vazhduar. [...] PDK-ja nuk e vazhdoi procedurën. Ajo u largua nga seanca pas votimit të parë, nuk mori pjesë në konsultimet dhe vazhdimin pasues dhe, më 13 shtator, njoftoi se e tërhiqte, përkatësisht e pezullonte kandidaturën dhe se do të përmbahej nga propozimi e nga e pjesëmarrja deri në nxjerrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.”.*
134. Gjithashtu, Kryetarja e Kuvendit thekson se: *“Kushtetuta e Republikës së Kosovës e as jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese nuk e njohin konceptin e pezullimit (tërheqjes) të kandidaturës për nënkryetar të Kuvendit për një periudhë të përkohshme. Pra vetë kërkesa me objekt themelor pezullimi ose tërheqje është antikushtetuese, prandaj, meqë një praktikë e tillë nuk njihet nga sistemi kushtetues e juridik i Kosovës, atëherë veprimi i tillë i PDK-së, kualifikohet saktësisht sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në kategorinë kushtetuese të mos ushtrimit të të drejtës kushtetuese të mos ushtrimit të të drejtës së pjesëmarrjes në Kryesinë e Kuvendit.”.*
135. Tutje, Kryetarja e Kuvendit duke iu referuar paragrafëve 138-140 të rastit të Gjykatës KO325/25 argumentojnë se: *“[...] mekanizimi përjashtimor nuk zbatohet kur e drejta e propozimit është ushtruar.”.* Në këtë drejtim, Kryetarja e Kuvendit thekson se: *“Pozita nënkryetarit nga PDK nuk është plotësuar nga shumica, nuk i është bartur një grupi tjetër dhe nuk është shuar. Ajo vazhdon të jetë e rezervuar për kandidatin që propozon PDK-ja. Kësisoj pas konstituimit të Kuvendit dhe refuzimit për të marrë pjesë në kryesi, ne kemi të drejtën kushtetuese për të ia votuar PDK-së sërish një kandidat për nënkryetar të Kuvendit të Kosovës. Kjo masë ruan përfaqësimin proporcional, ndërsa njëkohësisht pengon paralizën e institucionit.”.*
136. Përkitazi me Vendimin për Zgjedhjen e Qeverisë, Kryetarja e Kuvendit thekson se parashtruesit e kërkesave nuk identifikojnë ndonjë shkelje në procedurën e përcaktuar me nenin 95 të Kushtetutës duke shtuar se: *“Në momentin e votimit të Qeverisë nuk ekzistonte ndonjë masë e përkohshme e Gjykatës që ndalonte veprimet e Kuvendit. Për këtë arsye, një grup parlamentar nuk mund t’ia jepte në mënyrë të njëanshme njoftimit ose paralajmërimit të vet efektin juridik të një mase të përkohshme.”.*
137. Në këtë drejtim, Kryetarja e Kuvendit konsideron se: *“[...] Vendimi nr. 11-V-007 është marrë në përputhje me nenin 95 paragrafi 3 të Kushtetutës dhe nuk ka asnjë shkelje të asnjë forme në këtë procedurë.”.*

138. Në vazhdim, Kryetarja e Kuvendit konsideron se: “Mirëbesimi kërkon që procesi të mos pamundësohet përmes mungesës, përmbajtjes nga paraqitja e propozimit ose kushtëzimit të pjesëmarrjes me një ngjarje të ardhshme, pa ekzistuar një masë e përkohshme e Gjykatës.”
139. Përkitazi me kërkesën e parashtresve të kërkesës për masë të përkohshme, Kryetarja e Kuvendit konsideron se: “[...] pezullimi i përgjithshëm do të prodhonte dëm të drejtpërdrejtë, do të ndalonte përfaqësimin e qytetarëve, ligjvënien. Mbikëqyrjen parlamentare, funksionimin e Qeverisë dhe përmbushjen e afateve tjera kushtetuese. Balanca e interesave anon qartë kundër një mase kaq të gjerë.”. Në këtë drejtim, Kryetarja e Kuvendit shton se: “[...] kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet. Nëse Gjykata e sheh të nevojshëm ndonjë sigurim të përkohshëm, ai duhet të kufizohet vetëm në ruajtjen e pozitës së nënkryetarit të PDK-së e cila tashmë është ruajtur pa pezulluar Kuvendin, Qeverinë ose procedurat e tjera kushtetuese.”.
140. Në fund, Kryetarja e Kuvendit i propozon Gjykatës që: “a. ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme; b. të konstatojë se Vendimi nr. 11-V-002, i 9 shtatorit 2026, është marrë në përputhje me kërkesat materiale të nenit 67 paragrafi 2 të Kushtetutës; c. të konstatojë se vendimi procedural i 11 shtatorit 2026 për votimin veç e veç të kandidatëve për nënkryetar të Kuvendit nuk është në kundërshtim me nenet 67 dhe 76 të Kushtetutës, me Rregulloren e Kuvendit ose me standardet e jurisprudencës kushtetuese; d. të konstatojë se PDK-së i është garantuar dhe mundësuar ushtrimi i së drejtës së propozimit dhe se moszgjedhja e znj. Vlorë Çitaku në votimin e parë nuk përbënte mosushttrim të kësaj të drejte; e. të konstatojë se, në fazën pasuese, tërheqja, përkatësisht pezullimi i kandidaturës, përmbajtja nga propozimi dhe mospjesëmarrja në vazhdimin e procedurës përbënin mosushttrim të mëtejshëm të së drejtës në kuptim të paragrafit 148 të KO265/25; ë. Të konstatojë se Kuvendi ka mundur të vazhdojë funksionimin me pesë anëtarë të Kryesisë dhe me pozitën e PDK-së të lënë të lirë dhe të rezervuar; f. të konstatojë se Vendimi nr. 11-V-007, i 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë është marrë në përputhje me nenin 95 paragrafi 3 të Kushtetutës, pas paraqitjes së përbërjes së Qeverisë dhe sigurimit të 62 votave për; dhe g. t'i refuzojë pretendimet e tjera të KO256/26 dhe KO258/26 si të pabazuara”.

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 4

[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

- “1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.

6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.”

Neni 7

[Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, pages, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”

Neni 16

[Epërsia e Kushtetutës]

“1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.

2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.

3. Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.

4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.”

Neni 63

[Parimet e Përgjithshme]

“Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.”

Neni 66

[Zgjedhja dhe Mandati]

“1. Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.

2. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.

4. Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për aq sa zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë.

5. Kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore, rregullohen me ligj.”

Neni 67
[Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve]

- “1. Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.
2. Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
3. Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
4. Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.
5. Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me votën e shumicës prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.
6. Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit.”*

Neni 74
[Ushtrimi i Funksionit]

“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”

Neni 76
[Rregullorja e Punës]

“Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.”

Neni 82
[Shpërndarja e Kuvendit]

- “1. Kuvendi shpërndahet në këto raste: (1) (2) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria; nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës; (3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.
2. Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.”*

Neni 83
[Statusi i Presidentit]

“Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës.”

Neni 86 **[Zgjedhja e Presidentit]**

- “1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.*
- 2. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.*
- 3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidatë për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidatë për President të Republikës së Kosovës.*
- 4. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- 5. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.*
- 6. Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.”*

Neni 92 **[Parimet e Përgjithshme]**

- “1. Qeverinë e Kosovës e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.*
- 2. Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligj.*
- 3. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësisive të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.*
- 4. Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo.”*

Neni 93 **[Kompetencat e Qeverisë]**

“Qeveria ka këto kompetenca:

- (1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;*
- (2) mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;*
- (3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;*
- (4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;*
- (5) propozon Buxhetin e Republikës së Kosovës;*
- (6) udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës;*
- (7) udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike;*
- (8) i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misioneve diplomatike të Kosovës;*
- (9) propozon amendamentimin e Kushtetutës;*
- (10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;*

(11) ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore.”

Neni 95 **[Zgjedhja e Qeverisë]**

“1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.

2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.

3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.

5. Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.

6. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.”

Neni 116 **[Efekti Juridik i Vendimeve]**

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme.

3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.

4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallet në Gazetën Zyrtare.

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Neni 7 **(Seanca konstituive)**

“1. Seancën konstituive të Kuvendit e thërret Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve.

2. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk e thërret seancën konstituive, Kuvendi mblidhet vetë në ditën e 30 (tridhjetë).”

Neni 11
(Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit)

- “1. Kryetari i Kuvendit zgjidhet në seancën konstituive, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- 2. Kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga subjekti politik më i madh në Kuvend, të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit.*
- 3. Kryesuesi i seancës konstituive konstaton rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, shpall zgjedhjen e Kryetarit dhe e fton të zërë vendin e tij.”*

Neni 12
(Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit)

- “1. Nënkryetarët e Kuvendit zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- 2. Kryetari i Kuvendit kërkon nga tri subjektet politike më të mëdha parlamentare të propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Kandidati për nënkryetar i subjektit më të madh parlamentar duhet të jetë i gjinisë tjetër, nga ai i Kryetarit.*
- 3. Në rast se dy ose më shumë subjekte politike kanë numër të njëjtë të deputetëve, e drejta e propozimit të nënkryetarit i takon subjektit që ka marrë më shumë vota në zgjedhjet për Kuvend.*
- 4. Kryetari i Kuvendit kërkon nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb që të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, si dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
- 5. Seanca konstituive përfundon me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Ndërprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë.*
- 6. Propozimet nga paragrafi 4 i këtij neni bëhen me shkrim, sipas procedurës si vijon:*
- 6.1. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb, dhe*
- 6.2. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet nga shumica e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.*
- 7. Në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas paragrafit 6 të këtij neni, propozimi i kandidatëve bëhet me short, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse. Kjo procedurë administrohet nga Kryetari i Kuvendit.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

141. Në lidhje me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës që përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*
142. Gjykata vëren se parashtuesit e kërkesave i kanë ngritur kërkesat e tyre bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e

qfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”

143. Përveç kriterëve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 [5] të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”

144. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit.

(2) [...]

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

(c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.

(4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”

145. Gjykata vëren se (i) më 14 shtator 2026, kërkesa KO256/26 është dorëzuar nga tetëmbëdhjetë (18) deputetë, të cilët kanë shënuar emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesë, ndërkaq që autorizimi për përfaqësim, i dorëzuar më 15 shtator 2026, është nënshkruar nga dhjetë (10) deputetë; (ii) më 15 shtator 2026, kërkesa KO258/26 është dorëzuar nga dhjetë (10) deputetë, të cilët kanë shënuar emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesë, ndërkaq autorizimi për përfaqësim është nënshkruar nga njëmbëdhjetë (11) deputetë.
146. Bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton që (i) kërkesa KO256/26 është parashtruar nga dhjetë (10) deputetë të Kuvendit, ndërkaq kërkesa KO258/26 është dorëzuar nga njëmbëdhjetë (11) deputetë të Kuvendit, të cilët kanë shënuar emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesën e tyre, duke përmbushur kriterin e përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës; (ii) parashtruesit e kërkesës KO256/26 kanë specifikuar se kontestojnë

kushtetutshmërinë e “Vendimit nr. 11-V-002, të 9 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit; Vendimit procedural të 11 shtatorit 2026 për mënyrën e votimit të nënkryetarëve; dhe konstatimit të 13 shtatorit 2026 për konstituimin e legjislaturës XI të Kuvendit”, ndërkaq që parashtruesit e kërkesës KO258/26 kanë specifikuar që kontestojnë kushtetutshmërinë e “Vendimit Nr. 11-V-007, të 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës”; (iii) të njëjtit u janë referuar neneve specifike të Kushtetutës me të cilat ata pretendojnë se aktet e kontestuara nuk janë në përputhshmëri dhe kanë dorëzuar argumentet në mbështetje të pretendimeve të tyre; si dhe (iv) parashtruesit e kërkesave kanë parashtruar kërkesën brenda afatit 8 (tetë) ditor, të përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligj.

147. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesave theksojnë që aktet e nxjerra në kuadër të Seancës Konstituive, të zhvilluara më 9, 11 dhe 13 shtator 2026 janë në kundërshtim me dispozitivin e Aktgjyimeve të Gjykatës në rastet [KO124/25](#), [193/25](#) dhe [KO196/25](#), [KO265/25](#), si dhe [KO325/25](#), dhe, në mënyrë specifike, kontestojnë: (i) procedurën për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit, që pretendojnë se është bërë pas afatit kushtetues tridhjetë (30) ditor; (ii) procedurën për mënyrën e votimit veç e veç të katër (4) nënkryetarëve dhe konstatimin e Kryetares së zgjedhur se Kuvendi është konstituuar “pa zgjedhjen e nënkryetarit nga grupi parlamentar i PDK-së”; si dhe (iii) Vendimin [Nr. 11-V-007] të 13 shtatorit 2026 të Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë.
148. Për më tepër, duke qenë se nga parashtruesit e kërkesave kontestohen vendimet dhe veprimet procedurale të Kuvendit përkritazi me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, përkatësisht konstituimin e Kuvendit, si dhe vendimin për zgjedhjen e Qeverisë, të cilat janë nxjerrë në kuadër të zhvillimit të Seancës Konstituive të Kuvendit, të 9, 11 dhe 13 shtatorit 2026, Gjykata vlerëson se të njëjtat i nënshtrohen vlerësimit dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi bazuar në praktikën e saj gjyqësore, edhe vetë çështja e Seancës Konstituive të Kuvendit përbën çështje kushtetuese, e cila duhet t’i nënshtrohet vlerësimit dhe interpretimit të Gjykatës (shih, rastet e Gjykatës: [KO124/25](#), parashtrues Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë tjerë të Kuvendit, Aktgjykim i 26 qershorit 2025, paragrafët 83-84 dhe 86; [KO265/25](#), parashtrues Igor Simić dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 30 shtatorit 2025, paragrafi 92; dhe [KO325/25](#), parashtrues Igor Simić dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 28 janarit 2026, paragrafi 93).
149. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesave kanë përmbushur kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron që kërkesa e parashtruesve të kërkesave është e pranueshme për shqyrtim dhe në vijim, do të vazhdojë me vlerësimin e saj në merita.

Meritat e kërkesës

Hyrje

150. Gjykata rikujton se, më 7 qershor 2026 u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Më 8 korrik 2026, KQZ përmes Vendimit [nr. 011433-2026] certifikoi rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend. Më 24 korrik 2026, U.d. Presidentja, përmes Vendimit [nr. 30/2026] caktoi Seancën Konstituive të Legjislaturës së XI-të të Kuvendit, e cila u caktua të mbahet më 6 gusht 2026. Më 6 gusht 2026, filloi Seanca Konstituive, e kryesuar nga Kryesuesi, sipas rendit të ditës, si në vijim: (i) Formimi i

Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve; (ii) Betimi i deputetëve; (iii) Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit dhe (iv) Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit. Në të njëjtën ditë, pas përfundimit të verifikimit dhe kuorumit nga Komisioni i Përkohshëm, deputetët e zgjedhur të Kuvendit dhanë betimin e tyre. Më 9 shtator 2026, znj. Albulena Haxhiu u zgjodh Kryetare e Kuvendit, me gjashtëdhjetë e dy (62) vota për, gjashtëmbëdhjetë (16) kundër dhe trembëdhjetë (13) abstenime. Më 11 shtator 2026, deputeti z. Ardian Gola, nga Lëvizja Vetëvendosje!, u zgjodh nënkryetar i Kuvendit ndërkaq propozimi i grupit parlamentar të PDK-së që deputetja znj. Vlora Çitaku të zgjedhet nënkryetare e Kuvendit nuk kaloi pasi mori dyzet e katër (44) vota për, një (1) kundër dhe pesëdhjetë e gjashtë (56) abstenime. Më tej, më 13 shtator 2026, para përfundimit të Seancës Konstituive, grupi parlamentar i PDK-së kishte njoftuar Kryetaren e zgjedhur të Kuvendit për *“tërheqjen e përkohshme të kandidaturës së znj. Vlora Çitaku”* për nënkryetare të Kuvendit nga radhët e PDK-së, *“deri në sqarimin nga Gjykata të çështjes paraprake kushtetuese mbi tejkalimin e afatit për konstituim.”* Gjykata vëren që, më 13 shtator 2026 Kuvendi vazhdoi Seancën Konstituive gjatë së cilës zgjodhi tre (3) nënkryetarët e tjerë të Kuvendit, si dhe përmes Vendimit [Nr. 11-V-007] zgjodhi Qeverinë.

151. Parashtruesit e kërkesave para Gjykatës kontestojnë:

- (i) Vendimin [nr.11-V-002] e 9 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit, me pretendimin se i njëjti është miratuar në kundërshtim me Kushtetutën, pasi sipas parashtruesve të kërkesave: (a) është nxjerrë pas skadimit të afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit, i cili, sipas tyre, ka përfunduar më 7 gusht 2026; (b) brenda afatit tridhjetë (30) ditor duhet të përfundojë tërësisht procesi i konstituimit të Kuvendit, përkatësisht të përfundohet zgjedhja Kryetarit dhe nënkryetarëve dhe jo vetëm të provohet zgjedhja e tyre; dhe (c) është cenuar detyrimi procedural i përcaktuar përmes paragrafit 5 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit ku parashihet se ndërprerjet gjatë Seancës Konstituive nuk mund të jenë më të gjata se dyzet e tetë (48) orë, pasi sipas tyre pas 8 gushtit 2026, kanë kaluar javë pa vazhduar Seanca Konstituive;
- (ii) Vendimin procedural të 11 shtatorit 2026 për votimin veç e veç të nënkryetarëve të Kuvendit nga tri grupet më të mëdha parlamentare, duke pretenduar, ndër tjerash se: (a) pasojat e mënyrës së votimit veç e veç janë konkrete pasi përderisa kandidati i grupit më të madh u zgjodh me njëqind e një (101) vota, kandidatja e PDK-së mori dyzet e katër (44) vota për, një (1) kundër dhe pesëdhjetë e gjashtë (56) abstenime;
- (iii) mosparaqitjen e kandidaturës për nënkryetar të Kuvendit nga grupi parlamentar i PDK-së për shkak se sipas tyre: (a) PDK nuk refuzoi ta ushtrojë të drejtën e propozimit, pasi më 9 shtator 2026 kishin propozuar znj. Vlora Çitaku për nënkryetare, propozim i cili ishte vendosur në votim në Kuvend më 11 shtator 2026 dhe nuk mori shumicën e nevojshme; (b) kuorumi me pesë (5) anëtarë të Kryesisë nuk është kusht i mjaftueshëm për të kapërcyer rregullin e nenit 67 të Kushtetutës pasi kuorumi bëhet relevant vetëm pasi është aktivizuar në mënyrë të ligjshme përjashtimi i paragrafit 148 në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO265/25](#); dhe (c) PDK ka dorëzuar njoftim të shkruar me të cilin ka informuar Kryetaren e Kuvendit se mosparaqitja e kandidaturës është e përkohshme dhe nuk përbën heqje dore apo refuzim të së drejtës së propozimit; dhe
- (iv) Vendimin [Nr. 11-V-007] e 13 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Qeverisë, me pretendimin se nuk është në përputhje me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 4, 16, 66, 67, 74 dhe 92 të Kushtetutës, për shkak se është miratuar nga një Legjislaturë e cila nuk kishte përfunduar konstituimin në pajtim me kërkesat kushtetuese.

152. Komente ndaj kërkesave të parashtresve kanë dorëzuar Kryetarja e Kuvendit, Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!, grupi parlamentar i LDK-së, deputeti i AAK-së, z. Burim Ramadani dhe Grupi Multietnik. Pretendimet e parashtresve të kërkesave kundërgargumentohen nga Kryetarja e Kuvendit dhe Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!, të cilët konsiderojnë se (i) pasoja në rast të kalimit të afatit kushtetues për konstituimin e Kuvendit nuk përcaktohet me Kushtetutë; (ii) mosrespektimi i përcaktimit se ndërprerjet gjatë Seancës Konstituive nuk mund të jetë më të gjata se dyzet e tetë (48) orë, nuk shkakton shuarjen e kompetencës së seancës dhe nuk i bën të pavlefshme vendimet që pasojnë; (iii) Vendimi procedural për votimin veç e veç të nënkryetarëve ishte për një çështje të parregulluar shprehimisht dhe jo ndryshim i Rregullores së Kuvendit; (iv) PDK nuk e humbi të drejtën e propozimit të kandidatit për nënkryetar të Kuvendit, por ajo e pezulloi ushtrimin e saj dhe se Kuvendi nuk *“pranoi që pezullimi i njëanshëm të bëhej pezullim i institucionit”*; (v) pretendimet e parashtresve të kërkesave për vlerësimin e ligjshmërisë së mosveprimeve të 6 dhe 8 gushtit nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit, për shkak të kalimit të afatit prej tetë (8) ditëve nga ato zhvillime; dhe (vi) Vendimi për zgjedhjen e Qeverisë kontestohet mbi bazën e fazës së mëparshme dhe kërkohet që *“ta zhvleftësojë automatikisht vendimin e marrë sipas nenit 95”*, pasojë që nuk është e përcaktuar me Kushtetutë. Në anën tjetër, Gjykata vëren se deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik theksojnë se (i) karakteri detyrues i afatit tridhjetë (30) ditor nuk nënkupton se, pas kalimit të tij, deputetët humbin kompetencën për të përfunduar konstituimin e Kuvendit; (ii) vazhdimi i konstituimit të Kuvendit me zgjedhjen e nënkryetarëve nuk e cenoi përfaqësimin e PDK-së dhe se vota e deputetëve të komuniteteve nuk mund të konsiderohet e pavlefshme për shkak të mosplotësimit të një pozite që i takonte një grupi tjetër parlamentar; (iii) Kushtetuta dhe Rregullorja e punës së Kuvendit nuk përcaktojnë se kalimi i afatit prej dyzet e tetë (48) orëve për vazhdimin e Seancës Konstituive e shuan mandatin e deputetëve ose e bën juridikisht të pamundur vazhdimin e seancës; dhe (iv) Vendimi i 13 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Qeverisë është i vlefshëm. Përderisa, deputetët e LDK-së konsiderojnë se: (i) Gjykata duhet të japë një interpretim të drejtpërdrejtë dhe përfundimtar mbi efektin juridik të tejkalimit të afatit tridhjetë (30) ditor lidhur me vlefshmërinë e akteve konstituive të miratuara nga Kuvendi; dhe se (ii) pezullimi i rrjedhjes së afateve është i domosdoshëm, në mënyrë që të parandalohen pasoja të pariparueshme. Në fund, Deputeti z. Burim Ramadani përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë argumenton, ndër të tjera, se: (i) afati tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit përfundoi më 7 gusht 2026 dhe se zgjedhja e Kryetares së Kuvendit përmes Vendimit të 9 shtatorit 2026 ka ndodhur tridhjetë e tri (33) ditë pas skadimit të afatit kushtetues; (ii) nuk është respektuar detyrimi procedural për vazhdimin e seancës brenda dyzet e tetë (48) orëve; dhe (iii) Vendimi i 13 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Qeverisë është nxjerrë nga një Kuvend që nuk është i konstituuar.
153. Duke marrë për bazë pretendimet e parashtresve të kërkesave, si dhe argumentet dhe kundërgargumentet e palëve të interesuara, Gjykata konsideron se çështje kushtetuese dhe objekt i vlerësimit të kësaj kërkeje përbëjnë çështjet si në vijim:
- (i) Vlerësimi i pretendimeve nëse Kuvendi është konstituuar pas kalimit të afatit tridhjetë (30) ditor, të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës, si dhe efektet e këtij afati lidhur me afatet e përcaktuara kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit dhe zgjedhjen e Qeverisë;
 - (ii) Vlerësimi i Vendimit [nr. 11-V-002] të 9 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit dhe Vendimeve [nr. 11-V-003, të 11 shtatorit 2026; nr. 11-V-004; nr. 11-V-005; dhe nr. 11-V-006 të 13 shtatorit 2026] të Kuvendit për zgjedhjen e katër (4) nënkryetarëve të Kuvendit, dhe i të drejtës së grupit të dytë më të madh parlamentar

- për të propozuar kandidatin dhe zgjedhjen e Nënkryetarit të Kuvendit, të përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 67 të Kushtetutës;
- (iii) Vlerësimin e Vendimit [Nr. 11-V-007] të 13 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Qeverisë; dhe
 - (iv) Vlerësimin e efekteve në fillimin dhe rrjedhjen e afatit kushtetues për zgjedhjen e Presidentit, në rastet kur posti i Presidentit është vakant dhe ushtrohet nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit.
154. Për këtë qëllim, Gjykata fillimisht do të elaborojë parimet dhe vlerat e përgjithshme të përcaktuara në Kushtetutë, të cilat ndërlidhen me procedurën e konstituimit të Kuvendit dhe me zgjedhjen e institucioneve kushtetuese pas përfundimit të zgjedhjeve. Gjykata do të vijojë me vlerësimin e vendimeve dhe çështjeve të sipërpërmendura, të cilat ndërlidhen me procedurën e konstituimit të Kuvendit, për të vazhduar me vlerësimin e pasojave, në kuptim të detyrimit të respektimit të afateve të përcaktuara me Kushtetutë për zgjedhjen e institucioneve kushtetuese pas konstituimit të Kuvendit.
155. Para se të vazhdojë me vlerësimin e çështjeve të ngritura para saj, Gjykata vë në dukje se ajo në vazhdimësi ka theksuar se kur vlerësohet kushtetutshmëria e një çështjeje të ngritur para saj, ajo merr për bazë Kushtetutën si tërësi, si dhe dispozitat themelore të saj në Kapitullin I [Dispozitat Themelore] të Kushtetutës, e që interpretohen në lidhshmëri me dispozitat kushtetuese të çështjes së kontestuar. Gjykata në raste të tilla trajton kushtetutshmërinë e çështjes në kuptim të sundimit të ligjit dhe interesit të përgjithshëm dhe jo interesave subjektive të ndonjëres nga palët në procedurë (shih, rastet e Gjykatës [KO193/25](#) dhe [KO196/25](#), parashtues në rastin [KO193/25](#), *Memli Krasniqi dhe 12 (dymbëdhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* dhe në rastin [KO196/25](#), *Hykmete Bajrami dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 7 gushtit 2025, paragrafi 178).

Parimet e përgjithshme kushtetuese

156. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë shteti i Republikës së Kosovës. Këto parime dhe vlera mishërojnë dhe pasqyrojnë frymën e Kushtetutës, e cila është e transpozuar në secilën normë të saj. Si e tillë, Kushtetuta dhe secila normë e saj duhet të interpretohen në ndërvlerësi me njëra tjetrën dhe jo të izoluar nga njëra tjetra, dhe gjithnjë duke pasur parasysh parimet dhe vlerat e saj. Asnjë normë e Kushtetutës nuk mund të interpretohet në mënyrë të ndarë dhe të izoluar nga parimet dhe vlerat e përcaktuara në Kushtetutë, përfshirë Preambulën e saj. Asnjë normë kushtetuese nuk mund të nxirret jashtë kontekstit dhe të interpretohet në mënyrë të shkëputur nga pjesa tjetër e Kushtetutës. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera të saj (shih, rastet e Gjykatës: [KO72/20](#), parashtues *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 qershorit 2020, paragrafi 346; dhe [KO72/26](#) dhe [KO74/26](#), parashtues në rastin [KO72/26](#), *Qeveria e Republikës së Kosovës* dhe në rastin [KO74/26](#), *Arbërie Nagavci dhe 30 (tridhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 25 marsit 2026, paragrafi 117).
157. Në kuptim të dispozitave themelore kushtetuese, Gjykata thekson se neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, ku mes tjerash, saktëson që Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është

përcaktuar me këtë Kushtetutë, parime këto sipas të cilave, (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Presidenti është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe duke përfaqësuar unitetin e popullit sipas të njëjtës; (iii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; (iv) pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat; dhe (v) Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës [KO124/25](#), parashtres *Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 26 qershorit 2025, paragrafi 101).

158. Gjykata po ashtu rithekson që struktura e normave kushtetuese, dhe posaçërisht ajo që ndërlidhet me themelimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore duhet të interpretohet në atë mënyrë që të jetësojë dhe jo të bllokojë themelimin dhe ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre. Kësisoj, dhe në kuptim të funksionimit efektiv të institucioneve shtetërore, Gjykata ka theksuar rëndësinë e interpretimit të Kushtetutës përkritazi me themelimin e organeve kushtetuese, duke vlerësuar se përderisa funksionimi demokratik i institucioneve shtetërore është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike, të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizim publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin (shih, në lidhje me këtë rastin e Gjykatës [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 111 dhe rastet [KO72/26](#) dhe [KO74/26](#), cituar më lart, paragrafi 121).

Kuvendi në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës

159. Gjykata përmes praktikës gjyqësore ka nënvizuar se hapi i parë në formimin e institucioneve kushtetuese pas zgjedhjeve, sikurse është përcaktuar në Kushtetutë, përkatësisht pas shpalljes të rezultateve të zgjedhjeve, është konstituimi i Kuvendit, i cili bazuar në paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës, duhet të përmbushet me sukses brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es sipas paragrafit 2 të nenit 67 dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës (shih, Aktgjykimet e Gjykatës në rastet [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 93; [KO193/25](#) dhe [KO196/25](#), cituar më lart, paragrafi 97; si dhe [KO265/25](#), cituar më lart, paragrafi 104).
160. Gjykata duke u bazuar në nenin 2 [Sovraniteti] të Kushtetutës ka theksuar se sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të popullit, në pajtim me Kushtetutën. Në veçanti, përfaqësuesit e zgjedhur të popullit janë deputetët e Kuvendit të zgjedhur në zgjedhje të lira dhe demokratike. Ushtrimi i sovranitetit përmes të zgjedhurve të popullit është modaliteti kryesor dhe më i përhapur për të shprehur atë se çfarë “buron nga populli” dhe për ta reflektuar atë në veprime dhe vendime konkrete përmes sistemit të demokracisë përfaqësuese (shih, rastin e Gjykatës [KO72/20](#), cituar më lart, paragrafët 348-349).
161. Gjykata fillimisht thekson që njëra ndër kompetencat thelbësore të Kuvendit, është edhe kompetenca për të zgjedhur Presidentin e Republikës së Kosovës.

Presidenti në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës

162. Presidenti, si kreu i shtetit, *inter alia*, përfaqëson unitetin e popullit dhe është garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës (shih nenet 4 dhe 83 të Kushtetutës dhe rastet [KO72/26](#) dhe [KO74/26](#), cituar më lart, paragrafët 127 dhe 128). Kompetencat e Presidentit janë të përcaktuara me nenin 84 të Kushtetutës, dhe se “pushteti, funksionet, detyrat dhe kompetencat” e Presidentit janë të përcaktuara edhe në nene të tjera të Kushtetutës, përkatësisht nenet “4, 18, 60, 66, 69, 79, 80, 82, 93, 94, 95, 104, 109, 113, 114, 118, 126, 91 127, 129, 131, 136, 139, 144, 150 dhe 158.” (shih, rastin [KO72/20](#), cituar më lart, paragrafi 359). Në kuadër të ndërveprimit të institucioneve kushtetuese për qëllim të zbatimit të përgjegjësi të tyre, gjithnjë duhet pasur parasysh edhe parimin themelor të ushtrimit të ndërvuarur të kompetencave kushtetuese (shih, rastin e Gjykatës [KO72/20](#), cituar më lart, paragrafi 360).

Qeveria në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës

163. Në bazë të nenit 92 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, Qeveria e Republikës së Kosovës përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat dhe ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Kompetencat e Qeverisë janë specifikuar në nenin 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, përmes të cilit ndër tjerash në kuadër të kompetencave të saj, Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e miratuara nga Kuvendi, përcakton dhe zbaton politikat e brendshme dhe të jashtme, propozon projektligje dhe Buxhetin e Republikës së Kosovës, nxjerr akte juridike për zbatimin e ligjeve, udhëheq dhe mbikëqyr administratën dhe shërbimet publike, ushtron kompetenca në fushën e politikës së jashtme dhe të emërimeve diplomatike, si dhe ushtron funksione të tjera ekzekutive të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.

I. Vlerësimi i pretendimeve lidhur me “konstituimin e Kuvendit pas kalimit të afatit tridhjetë (30) ditor

A. Pretendimi i parashtruesve të kërkesës

164. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës në rastin KO256/26 pretendojnë se Vendimi [nr.11-V-002] i 9 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Kryetares së Kuvendit është miratuar në kundërshtim me Kushtetutën, pasi sipas tyre (i) ky vendim është nxjerrë pas skadimit të afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit, i cili, sipas tyre, ka përfunduar më 7 gusht 2026; (ii) sipas jurisprudencës së Gjykatës në rastet [KO124/25](#), [KO193/25](#) dhe [KO196/25](#), [KO265/25](#), si dhe [KO325/25](#), brenda afatit tridhjetë (30) ditor duhet të përfundojë tërësisht procesi i konstituimit të Kuvendit, përkatësisht të përfundohet zgjedhja Kryetarit dhe nënkryetarëve dhe jo vetëm të provohet zgjedhja e tyre; (iii) është cenuar detyrimi procedural i përcaktuar përmes paragrafit 5 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit ku parashihet se ndërprerjet gjatë Seancës Konstituive nuk mund të jenë më të gjata se dyzet e tetë (48) orë, pasi pas 8 gushtit 2026, kanë kaluar javë pa vazhduar Seanca Konstituive; dhe (iv) dështimi për të zgjedhur Kryetarin e Kuvendit brenda afatit tridhjetë (30) ditor nuk mund t’u atribuohet deputetëve në përgjithësi pasi mosparaqitja e kandidatit për Kryetar të Kuvendit nga grupi më i madh parlamentar ka pamundësuar përfundimin e konstituimit të Kuvendit brenda afatit të përcaktuar me Kushtetutë.
165. Në vijim, parashtruesit e kërkesës po ashtu specifikojnë që: “[...] skadimi i afatit nuk e shuan detyrimin material për konstituimin e Kuvendit dhe se ky detyrim vazhdon sepse shteti duhet të ketë organ legjislativ funksional. Megjithatë, vazhdimi i detyrimit nuk mund të barazohet me mungesën e pasojës juridike të skadimit. Pas 7 gushtit, shkelja e

afatit ishte konsumuar dhe konstituimi i mëvonshëm nuk mund ta transformojë retroaktivisht një konstituim jashtë afatit në konstituim brenda afatit. [...]”. Në lidhje me çështjen e trajtimit të afatit nga ana e Gjykatës, parashtruesit e kërkesës mbështeten tek rastet e Gjykatës KO72/26 dhe KO74/26, për të cilat argumentojnë se, edhe pse kishin objekt tjetër, parimi interpretues është relevant pasi që *“afati i shkruar në Kushtetutë nuk mund të reduktohet në orientim pa pasoja, sepse një interpretim i tillë do ta zbraste normën nga përmbajtja dhe qëllimi i saj”.*

166. Përkitazi me tejkalimin e afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesve të kërkesave kundërargumentohen nga (i) Kryetarja e Kuvendit dhe Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!, të cilët pretendojnë se pasoja në rast të kalimit të afatit kushtetues për konstituimin e Kuvendit nuk përcaktohet me Kushtetutë; si dhe (ii) Grupi Multietnik, të cilët theksojnë se karakteri detyrues i afatit tridhjetë (30) ditor nuk nënkupton se, pas kalimit të tij, deputetët humbin kompetencën për të përfunduar konstituimin e Kuvendit. Në anën tjetër, (iii) deputeti z. Burim Ramadani përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë kundërargumenton se afati tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit përfundoi më 7 gusht 2026 dhe se zgjedhja e Kryetares së Kuvendit përmes Vendimit të 9 shtatorit 2026 ka ndodhur pas skadimit të afatit kushtetues; ndërkaq që (iv) deputetët e LDK-së konsiderojnë se Gjykata duhet të japë një interpretim të drejtpërdrejtë dhe përfundimtar mbi efektin juridik të tejkalimit të afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit.

B. Vlerësimi i pretendimeve

167. Gjykata rikujton që paragrafi 1 i nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës përcakton që: *“Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.”*
168. Së pari, Gjykata vë në dukje se në rastin [KO124/25](#) ka interpretuar dhe ka dhënë konstatimin e saj lidhur me afatin tridhjetë (30) ditor të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës për konstituimin e Kuvendit. Për më tepër, procedura e konstituimit të Kuvendit përmes zgjedhjes së Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit është elaboruar dhe trajtuar në mënyrë të shteruar edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, në rastet [KO193/25 dhe KO196/25](#); [KO265/25](#); dhe [KO325/25](#).
169. Gjykata rithekson se interpretimi dhe konstatimi i Gjykatës lidhur me afatin tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit, ashtu siç është elaboruar përmes Aktgjykimit në rastin [KO124/25](#), janë të aplikueshme dhe nuk do të angazhohet në interpretimin e mëtejshëm të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës. Gjykata në rastin [KO124/25](#) kishte konstatuar që Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës është një akt kushtetues që duhet të përmbushet me sukses brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es sipas paragrafit 2 të nenit 67 dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës. Çdo interpretim ndryshe do të relativizonte rendin kushtetues, respektivisht Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe do të nënkuptonte tolerim të bllokimit institucional, në kundërshtim me natyrën funksionale të një demokracie të udhëhequr nga parimet e demokracisë dhe të sundimit të ligjit (shih, rastin e Gjykatës [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 145).

170. Prandaj, përkitazi me procedurën e afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit Gjykata konsideron se nuk paraqiten rrethana të reja që do të arsyetonin një vlerësim dhe interpretim të këtij afati, i cili shprehimisht është i përcaktuar edhe me paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës dhe se kjo çështje përbën tashmë çështje të gjykuar (*res judicata*) nga Gjykata Kushtetuese.
171. Duke iu rikthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata vë në dukje se (i) më 8 korrik 2026, KQZ përmes Vendimit [nr. 011433-2026] certifikoi rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvend; (ii) më 24 korrik 2026, U.d. Presidentja, përmes Vendimit [nr. 30/2026] thirri Seancën Konstituive të Legjislaturës XI të Kuvendit, e cila u caktua të mbahet më 6 gusht 2026; (iii) më 6 gusht 2026, filloi Seanca Konstituive, e kryesuar nga Kryesuesi i Seancës Konstituive, sipas rendit të ditës, si në vijim: 1. Formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve; 2. Betimi i deputetëve; dhe 3. Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit dhe 4. Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit; (iv) në të njëjtën ditë, pas përfundimit të verifikimit të kuorumit nga Komisioni i Përkohshëm, deputetët e zgjedhur të Kuvendit dhanë betimin e tyre; (v) më 9 shtator 2026, znj. Albulena Haxhiu u zgjodh Kryetare e Kuvendit dhe më 11 shtator 2026 deputeti z. Ardian Gola, nga Lëvizja Vetëvendosje!, u zgjodh Nënkryetar i Kuvendit, ndërkaq që propozimi i grupit parlamentar të PDK-së që deputetja znj. Vlora Çitaku të zgjedhet Nënkryetare e Kuvendit nuk kaloi pasi mori dyzet e katër (44) vota për, një (1) kundër dhe pesëdhjetë e gjashtë (56) abstenime; dhe (vi) më 13 shtator 2026, Kuvendi vazhdoi Seancën Konstituive gjatë së cilës zgjodhi tre (3) Nënkryetarët e tjerë të Kuvendit, si dhe përmes Vendimit [Nr. 11-V-007] zgjodhi Qeverinë.
172. Në kuptim të procedurës së zhvilluar, Gjykata fillimisht vëren që Seanca Konstituive nga U.d. Presidentja është thirrur të mbahet në ditën e 29-të pas certifikimit të rezultateve zgjedhore nga KQZ. Thënë këtë, Gjykata vë në dukje se çështjen e afatit kushtetues, përkatësisht afatin tridhjetë (30) ditor të specifikuar edhe në paragrafin 1 të nenit 66 e kishte për objekt shqyrtimi edhe në rastin KO124/25. Gjykata, në kuptim të përcaktimeve në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës, po ashtu ka specifikuar se vetë struktura e kësaj dispozite kushtetuese nënkupton se mbajtja e Seancës Konstituive brenda afatit tridhjetë (30) ditor, nuk është mundësi formale apo orientuese, por detyrim kushtetues që lidhet ngushtë me fillimin e mandatit të legjislaturës së re (shih, rastin e Gjykatës [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 131). Në vijim, Gjykata vëren që paragrafi 3 i nenit 66 të Kushtetutës përcakton që: *“Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.”*
173. Në këtë drejtim, Gjykata sërish thekson se përderisa funksionimi demokratik i institucioneve shtetërore është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike, të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizim publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin. Për këtë qëllim, paragrafi 3 i nenit 66 të Kushtetutës në mënyrë të qartë përcakton mundësinë që në rast se Presidenti nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se një detyrim për thirrje të Seancës Konstituive të Kuvendit përveç se bie në përgjegjësinë e Presidentit bie edhe në përgjegjësinë e deputetëve të zgjedhur të Kuvendit, të cilët kanë fituar besimin e popullit për të konstituuar dhe themeluar organet kushtetuese, siç në rrethanat konkrete është Kuvendi.

174. Gjykata rithekson rëndësinë e respektimit të nenit 66 të Kushtetutës si në kuptim të thirrjes së Seancës Konstituive brenda afatit të përcaktuar kushtetues pas certifikimit të rezultateve si dhe zhvillimit e përfundimit të saj në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit. Thënë këtë, Gjykata rithekson që procedura për fillimin dhe përfundimin e Seancës Konstituive është e rëndësishë substanciale dhe funksionale, që nënkupton që brenda këtij afati duhet të realizohen të gjitha veprimet kushtetuese që rezultojnë në konstituimin e Kuvendit. Këto përfshijnë: (i) verifikimin e mandateve të deputetëve të zgjedhur, (ii) dhënien e betimit nga ana e tyre dhe (iii) zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe (iv) zgjedhjen e Nënkryetarëve të Kuvendit.
175. Në vijim, Gjykata vë në dukje detyrimet e Kryesuesit të Seancës Konstituive të përcaktuar me Kushtetutë, Rregulloren e Kuvendit dhe Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25 dhe rastet KO193/25 dhe KO196/25 për thirrjen dhe kryesimin e Seancës Konstituive deri në përfundimin me sukses të saj. Gjykata në rastet KO193/25 dhe KO196/25 ka vlerësuar se e drejta e deputetit më të vjetër në moshë për të drejtuar punimet e Seancës Konstitutive deri në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, ashtu siç parashihet në nenin 9 (Kryesimi i Seancës Konstitutive) të Rregullores së Kuvendit, duhet të interpretohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe në funksion të përmbushjes së qëllimit kushtetues të konstituimit të Kuvendit (shih, rastet e Gjykatës [KO193/25 dhe KO196/25](#), cituar më lart, paragrafi 124).
176. Për këtë qëllim, Gjykata u referohet edhe pretendimeve të parashtruesve të kërkesave, përmes të cilave theksojnë që është cenuar detyrimi procedural i përcaktuar përmes paragrafit 5 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit ku parashihet se ndërprerjet gjatë Seancës Konstituive nuk mund të jenë më të gjata se dyzet e tetë (48) orë.
177. Nga dokumentacioni i dorëzuar në Gjykatë rezulton që pas datës 8 gusht 2026, datë kjo kur ishte mbajtur seanca e dytë e Seancës Konstituive, Kryesuesi i Seancës Konstituive më 4 shtator 2026, përmes ftesës [L-XI SK-001/2] kishte caktuar vazhdimin e Seancës Konstituive për zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit për të mbajtur më 9 shtator 2026. Pas 9 shtatorit 2026, Seanca Konstituive kishte vazhduar punën më 11 dhe 13 shtator 2026. Thënë këtë, Gjykata vëren se nga data 8 gusht 2026 deri më 9 shtator 2026 nuk është mbajtur Seanca Konstituive për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Nënkryetarëve të Kuvendit.
178. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton që në rastet [KO193/25 dhe KO196/25](#) kishte vlerësuar se Kryesuesi i Seancës mbajtjen dhe zhvillimin e procedurës së Seancës Konstituive duhet ta realizojë në pajtim me detyrimet e përcaktuara me Kushtetutë, Kreun IV të Rregullores së Punës dhe përcaktimet e Aktgjykimit në rastet [KO193/25 dhe KO196/25](#). Gjykata në kuptim të përpjekjeve të vazhdueshme të Kuvendit për zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve brenda afatit 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e Aktgjykimit në rastet [KO193/25 dhe KO196/25](#) kishte rikujtuar rëndësinë e asaj që Kryesuesi i Seancës Konstituive mbajtjen e Seancës Konstituive duhet ta realizojë në pajtim me paragrafin 5 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit, i cili përcakton që “Ndërprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë.” (shih, rastet e Gjykatës [KO193/25 dhe KO196/25](#), cituar më lart, paragrafi 157).
179. Për më tepër, Gjykata ka specifikuar që Rregullorja e Kuvendit e miratuar sipas autorizimeve dhe kërkesave të nenit 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës përbën mjet dhe mekanizëm procedural përmes së cilës bëhet zbatimi i dispozitave kushtetuese

konkrete (shih, rastin e Gjykatës [KO119/14](#), cituar më lart, paragrafi 106). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se neni 76 i Kushtetutës e konsideron Rregulloren e Kuvendit, të miratuar nga 2/3 e votave të deputetëve si një akt me fuqi ligjore detyruese përmes së cilës rregullohet organizimi dhe funksionimi i Kuvendit. Për më tepër, kjo dispozitë kushtetuese obligon Kuvendin të veprojë brenda procedurave të miratuara nga vetë Kuvendi në përputhje me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës (shih, rastin e Gjykatës [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 148). Në këtë kuptim, Gjykata thekson se Kryesuesi i Seancës Konstituive është i detyruar që kompetencat e tij t'i ushtrojë në atë mënyrë që të sigurojë vazhdimin e Seancës Konstituive brenda afateve të përcaktuara me Kushtetutë dhe Rregulloren e Kuvendit.

180. Në vijim të kësaj, duke marrë për bazë faktin që rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme nga KQZ janë certifikuar më 8 korrik 2026, Gjykata konstaton që konstituimi i Kuvendit duhej të ishte përfunduar më së largu më 7 gusht 2026. Si rrjedhojë dhe bazuar në vlerësimin si më sipër të Gjykatës që Kuvendi është konstituuar pas afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës, Gjykata, megjithatë vë në dukje, se dispozitat e Kushtetutës nuk përcaktojnë që dështimi për konstituimin e Kuvendit brenda afatit tridhjetë (30) ditor ka për pasojë shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve. Për këtë arsye, Gjykata përmes Aktgjykimeve të saj në rastet [KO124/25](#); [KO193/25](#) dhe [KO196/25](#); [KO265/25](#) dhe [KO325/25](#) në vazhdimësi ka theksuar rëndësinë dhe detyrimin për fillimin dhe përfundimin e Seancës Konstituive në përputhje me parimet dhe vlerat kushtetuese e cila buron nga parimet dhe përcaktimet kushtetuese dhe e cila duhet të ndjekë frymën e mirëbesimit dhe bashkëpunimit konstruktiv të të gjithë deputetëve të zgjedhur. Për më tepër, ky detyrim ka për qëllim jetësimin dhe funksionalizimin e Kuvendit si organ përfaqësues i popullit, i cili është i mandatuar edhe për zgjedhjen e institucioneve kushtetuese si Presidenti dhe Qeveria.
181. Në këtë kontekst, duke marrë parasysh epërsinë e Kushtetutës, të përcaktuar me nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] të saj, si dhe detyrimin për respektimin dhe zbatimin efektiv të normave kushtetuese, Gjykata thekson se detyrimet, kushtet dhe afatet e përcaktuara me Kushtetutë kanë karakter detyrues dhe duhet të respektohen gjatë ushtrimit të kompetencave kushtetuese. Rrjedhimisht, kërkesat e tilla kushtetuese nuk mund të trajtohen si kërkesa thjesht formale apo të interpretohen në mënyrë që të humbasin karakterin e tyre detyrues. Megjithatë, Gjykata thekson se karakteri detyrues i një dispozite kushtetuese duhet dalluar nga përcaktimi i pasojave që rrjedhin nga mosrespektimi i saj.
182. Në vijim, marrë për bazë konstatimin si më sipër se dështimi për konstituimin e Kuvendit brenda afatit tridhjetë (30) ditor nuk ka për pasojë shpërndarjen e Kuvendit me automatizëm, Gjykata thekson që kalimi i afatit kushtetues për konstituimin e Kuvendit nuk i liron deputetët e zgjedhur të Kuvendit nga detyrimi për konstituimin e tij. Thënë këtë, konstituimi i Kuvendit, përveçse përbën parakusht për ushtrimin e kompetencave kushtetuese të këtij institucioni, ndërlikohet edhe me fillimin dhe zhvillimin e procedurave të tjera kushtetuese.
183. Si rrjedhojë, Gjykata ka theksuar që afatet për zgjedhjen e Qeverisë dhe për zgjedhjen e Presidentit ndërlikohen me konstituimin e Kuvendit, megjithatë kjo me kushtin që respektohet afati detyrues prej tridhjetë (30) ditësh i përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, kalimi i afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit nuk mund të jetë pa efekt juridik. Kjo për faktin që efekti i kalimit të afatit detyrues të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës për konstituimin e Kuvendit brenda tridhjetë (30) ditëve pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve është

drejtpërsëdrejti i ndërlidhur me rrjedhjen e afateve për zgjedhjen e institucioneve tjera kushtetuese, siç është (i) zgjedhja e Presidentit, në rastin kur Presidenti nuk është i zgjedhur dhe posti i tij ushtrohet nga një ushtrues i detyrës së Presidentit; dhe (ii) zgjedhja e Qeverisë.

184. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se, në rastet KO72/26 dhe KO74/26, duke trajtuar rrethanat në të cilat nuk kishte Kuvend të konstituuar dhe funksional, kishte përcaktuar se procedura për zgjedhjen e Presidentit duhet të fillojë nga dita e konstituimit të Kuvendit dhe të përfundojë më së largu brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit (shih, rastet e Gjykatës KO72/26 dhe KO74/26, cituar më lart, paragrafi 162).
185. Në vijim të kësaj, Gjykata do të elaborojë dispozitat kushtetuese lidhur me afatet për zgjedhjen e Qeverisë dhe të Presidentit në pajtim me praktikën e saj gjyqësore. Në këtë kuptim, përveç elaborimit të dispozitave kushtetuese, Gjykata i referohet interpretimit dhe konstatimeve të saj në rastin KO72/20 lidhur me afatin për zgjedhjen e Qeverisë, si dhe në rastet KO72/26 dhe KO74/26 lidhur me afatet për zgjedhjen e Presidentit dhe pasojat kushtetuese të moszgjedhjes së këtyre dy institucioneve brenda afateve të përcaktuara me nënparagrafët 1 dhe 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës.

Lidhur me afatin kushtetues për zgjedhjen e Qeverisë

186. Gjykata rikujton që paragrafët 1 deri 4 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës përcaktojnë që:

“1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.

2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.

3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

4. Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.

[...]”

187. Ndërsa, nënparagrafi 1 i paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës përcakton që: *“Kuvendi shpërndahet në këto raste: (1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria”.*
188. Gjykata në rastin KO72/20 ka specifikuar që për sa i përket afatit kohor brenda të cilit duhet të bëhet propozimi për kandidatin për Kryeministër, i njëjti duhet të analizohet në kuptim të: (i) sistemit të afateve kushtetuese që Kushtetuta ka përcaktuar për qëllime të formimit të Qeverisë; dhe (ii) natyrës së “konsultimit” në mes Presidentit dhe partisë politike ose koalicionit me të drejtën për të propozuar mandatarin për Kryeministër, përfshirë përgjegjësitë dhe detyrimet reciproke në mes tyre, për qëllime të caktimit të të

njëjtë. Në këtë kuptim, Gjykata kishte vlerësuar se caktimi i mandatarit nga Presidenti rezulton në rrjedhjen e dy lloj afatesh paralele kushtetuese: (i) atë të shpërndarjes së Kuvendit nëse zgjedhja e Qeverisë nuk bëhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga marrja e mandatit; dhe (ii) atyre të përcaktuara në nenin 95 të Kushtetutës, që ndërlidhen me dy mundësitë për formimin e Qeverisë, respektivisht afatin pesëmbëdhjetë (15) ditor brenda të cilit kandidati për Kryeministër paraqet përbërjen e Qeverisë dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit; (iii) afatin dhjetë (10) ditor, brenda të cilit Presidenti emëron kandidatin tjetër për Kryeministër, në rast se kandidati i parë për Kryeministër dështon t'i sigurojë votat e nevojshme në Kuvend apo edhe e refuzon mandatin përkatës; dhe (iv) duke iu referuar “*procedurës së njëjtë*”, afatin pesëmbëdhjetë (15) ditor, brenda të cilit kandidati tjetër për Kryeministër, paraqet përbërjen e Qeverisë dhe kërkon miratimin e saj nga ana e Kuvendit. (shih, rastin e Gjykatës [KO72/20](#), cituar më lart, paragrafët 485-486).

Lidhur me afatin kushtetues për zgjedhjen e Presidentit

189. Gjykata i referohet nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës, i cili specifikon që: “*Kuvendi shpërndahet në këto raste: [...] (3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.*”
190. Gjykata në rastet para saj [KO72/26 dhe KO74/26](#) ka theksuar se Kushtetuta nuk ka specifikuar shprehimisht rrethanën se kur fillon dhe përfundon procedura e zgjedhjes së Presidentit të ri, në rrethanat kur nuk ka një Kuvend të konstituuar dhe funksional, dhe kur gjatë kësaj periudhe përfundon mandati i Presidentit. Ndërlidhur me afatin për konstituimin e Kuvendit, Gjykata tashmë ka konstatuar që bazuar në interpretimin e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës, Seanca Konstituive e Kuvendit është një akt kushtetues që duhet të përmbushet me sukses brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes së të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit të Kuvendit (shih, rastin [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 145).
191. Në kontekstin specifik të rrethanave të një Kuvendi të shpërndarë dhe ende të pa konstituuar, Gjykata bazuar në interpretimin si më lart dhe qëllimin e normave kushtetuese, të përcaktuara përmes nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 ndërlidhur me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, ka konstatuar se procedura për zgjedhjen e Presidentit duhet të fillojë nga dita e konstituimit të Kuvendit dhe të përfundojë më së largu brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit (shih, rastet e Gjykatës [KO72/26 dhe KO74/26](#), cituar më lart, paragrafin 162).
192. Si rrjedhojë, Gjykata rithekson se interpretimi i saj lidhur me afatet kushtetuese të përcaktuara me nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, për zgjedhjen e Presidentit, ashtu siç është specifikuar në paragrafët 153-162 të Aktgjykimit në rastet [KO72/26 dhe KO74/26](#), mbeten të aplikueshme në të gjitha rastet e zgjedhjes së Presidentit në të ardhmen. Përkatësisht procedura për zgjedhjen e Presidentit të ri, e cila nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë duhet të fillojë përpara dhe të përfundojë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual. Si rrjedhojë e konstatimit të Gjykatës që afati për konstituimin e Kuvendit ka përfunduar më 7 gusht 2026, Gjykata konsideron që afati për zgjedhjen e Presidentit, në rast se posti i Presidentit është vakant ka filluar të rrjedhë më 8 gusht 2026.

193. Gjykata ka vlerësuar dhe konstatuar se afati për zgjedhjen e Qeverisë, si dhe afati për zgjedhjen e Presidentit ndërlidhen ngushtë me konstituimin e Kuvendit. Thënë këtë, Gjykata është nisur nga detyrimi i përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës që afati tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit duhet të respektohet dhe të zbatohet.
194. Në vijim, Gjykata do të vazhdojë me vlerësimin e procedurës së zgjedhjes së Kryetares dhe katër (4) nënkryetarëve dhe të drejtën e grupit të dytë më të madh parlamentar për propozimin e kandidatit për nënkryetar të Kuvendit dhe procedurën e zgjedhjes të tij/saj në pajtim me përcaktimet e nenit 67 të Kushtetutës.

II. *Lidhur me pretendimet për (i) procedurën e zgjedhjes së Kryetares dhe katër (4) Nënkryetarëve të Kuvendit dhe (ii) të drejtën e grupit të dytë më të madh parlamentar për propozimin e kandidatit për Nënkryetar të Kuvendit*

A. Pretendimet e parashtruesve të kërkesave

195. Lidhur me Vendimin procedural të 11 shtatorit 2026 për votimin veç e veç të nënkryetarëve të Kuvendit nga tri grupet më të mëdha parlamentare, parashtruesit e kërkesave pretendojnë se (i) pasojat e mënyrës së votimit veç e veç janë konkrete pasi përderisa kandidati i grupit më të madh u zgjodh me njëqind e një (101) vota, kandidatja e PDK-së mori dyzet e katër (44) vota për, një (1) kundër dhe pesëdhjetë e gjashtë (56) abstenime; (ii) shumica parlamentare nuk mund të krijojë përmes mënyrës së votimit dhe mosmbështetjes së kandidatit të propozuar një situatë të papërfunduar dhe ta përdorë atë situatë për të anashkaluar bartësin e së drejtës së propozimit; (iii) rezultati i procedurës u përdor si premisë për aktivizimin e një mekanizmi përjashtimor deblokues, i cili, sipas tyre, është në kundërshtim me praktikën e deritanishme parlamentare; dhe se (iv) grupi parlamentar i PDK-së nuk ka refuzuar ta ushtrojë të drejtën e propozimit të Nënkryetarit, pasi më 9 shtator 2026 ka propozuar znj. Vlora Çitaku, propozim i cili ishte vendosur në votim në Kuvend por nuk kishte marrë votat e mjaftueshme.
196. Gjykata rithekson se parashtruesit e kërkesave pretendojnë se mosparaqitja e kandidaturës së PDK-së nuk mund të trajtohet si mosushtim i së drejtës kushtetuese, për shkak se (i) PDK nuk refuzoi ta ushtrojë të drejtën e propozimit, pasi më 9 shtator 2026 kishin propozuar znj. Vlora Çitaku për nënkryetarë, propozim i cili ishte vendosur në votim në Kuvend më 11 shtator 2026 dhe nuk mori shumicën e nevojshme; (ii) fakti që Kryesia ka kuorum me pesë anëtarë nuk është kusht i mjaftueshëm për të kapërcyer rregullin e nenit 67 të Kushtetutës pasi kuorumi bëhet relevant vetëm pasi është aktivizuar në mënyrë të ligjshme përjashtimi i paragrafit 148 në Aktgjykimin e Gjykatës [KO265/25](#); dhe se (iii) ka dorëzuar njoftim të shkruar me të cilin ka informuar Kryetaren e Kuvendit se mosparaqitja e kandidaturës është e përkohshme dhe nuk përbën heqje dore apo refuzim të së drejtës së propozimit.
197. Në këtë drejtim, pretendimet e parashtruesve të kërkesave lidhur me Vendimin procedural të 11 shtatorit 2026 për votimin veç e veç të nënkryetarëve të Kuvendit nga tri grupet më të mëdha parlamentare, si dhe mosparaqitjes së kandidaturës së PDK-së, kundërgargumentohen nga Kryetarja e Kuvendit, grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! dhe Grupi Multietnik, të cilët pretendojnë se (i) Vendimi procedural për votimin veç e veç të nënkryetarëve ishte për një çështje të parregulluar shprehimisht dhe jo ndryshim i Rregullores së Kuvendit; (ii) PDK nuk e humbi të drejtën e propozimit të kandidatit për nënkryetar të Kuvendit, por ajo e pezulloi ushtimin e saj dhe se Kuvendi nuk “pranoi që pezullimi i njëanshëm të bëhej pezullim i institucionit”; dhe (iii) vazhdimi i

konstituimit të Kuvendit me zgjedhjen e nënkryetarëve nuk e cenoj përfaqësimin e PDK-së dhe se vota e deputetëve të komuniteteve nuk mund të konsiderohet e pavlefshme për shkak të mosplotësimit të një pozite që i takonte një grupi tjetër parlamentar.

B. Vlerësimi i Gjykatës

198. Lidhur me zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, Gjykata vëren se paragrafi 2 i nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës, përcakton që Kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Gjykata vlerëson se kjo dispozitë kushtetuese i jep të drejtën grupit më të madh parlamentar që të bëjë propozimin e kandidatit për Kryetar/e të Kuvendit, por njëkohësisht vendos detyrimin kushtetues që ky propozim duhet të marrë miratimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht 61 (gjashtëdhjetë e një) vota.
199. Në vijim dhe në kontekst të përfundimit të Seancës Konstituive përmes zgjedhjes së Kryetarit dhe Nënkyetarëve të Kuvendit, Gjykata rithekson detyrimin kushtetues të deputetëve të zgjedhur për konstituimin e Kuvendit. Domosdoshmëria për përmbushjen e pikave të rendit të ditës për konstituimin e Kuvendit buron në mënyrë të drejtpërdrejtë nga efektet dhe pasojat që konstituimi i organit përfaqësues kushtetues prodhon në funksionimin e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Në këto rrethana, dhe marrë për bazë kërkesat e parashtruara para saj, Gjykata në cilësinë e autoritetit përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, rithekson funksionin jetik të një Kuvendi të konstituuar pas zgjedhjeve, ku legjitimohen përfaqësuesit e zgjedhur të popullit për një mandat kushtetues përfaqësimi katër (4) vjeçar në Kuvendin e Republikës, dhe më pas, Qeverinë e tyre, të zgjedhur përmes Kuvendit, sipas procedurave të përcaktuara në Kushtetutë (shih paragrafin 11 të Aktgjykimit në rastet KO193/25 dhe KO196/25, cituar më lart).
200. Në rrethanat e kërkesave aktuale, përkatësisht procedurave të zhvilluara për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, Gjykata rikujton që më 9 shtator 2026, znj. Albulena Haxhiu u zgjodh Kryetare e Kuvendit me gjashtëdhjetë e dy (62) vota për, gjashtëmbëdhjetë (16) kundër dhe trembëdhjetë (13) abstenime.
201. Në vijim, dhe në kontekst të procedurës për zgjedhjen e Nënkyetarëve të Kuvendit, nga Transkripti i Seancës së 11 shtatorit 2026 të dorëzuar në Gjykatë, rezulton se, më 11 shtator 2026, me shtatëdhjetë e një (71) vota për, dhjetë (10) kundër dhe një (1) abstenim u miratua propozimi i Kryetares së Kuvendit që votimi i nënkryetarëve të bëhej veç e veç dhe jo në pako.
202. Në vlerësimin e pretendimit të parashtruesve të kërkesave, Gjykata nga elaborimi si më sipër vëren që e drejta për të zgjedhur Nënkyetarët e Kuvendit në pako apo sipas votimit veç e veç është e drejtë e deputetëve të zgjedhur në pajtim me mandatin e tyre kushtetues. Nga sa më sipër, Gjykata ka vlerësuar se në dispozitat kushtetuese, atyre të Rregullores së Kuvendit dhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës nuk përcaktohet ndonjë obligim i deputetëve për votimin në pako të Nënkyetarëve të Kuvendit, qofshin ata që propozohen nga 3 (tre) grupet më të mëdha parlamentare apo komunitetet që nuk janë shumicë. Në këtë kontekst, Gjykata ka vlerësuar se votimi në pako nuk është shprehimisht i përcaktuar në Kushtetutë, dhe se i njëjti mund të realizohet nëse ka dakordim në mes të grupeve parlamentare apo deputetëve. Gjykata ka vlerësuar që një procedurë e tillë e votimit mbetet në vullnetin e deputetëve dhe grupeve parlamentare me kushtin që të realizohet zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit (shih, rastet e Gjykatës [KO193/25](#) dhe [KO196/25](#), cituar më lart, paragrafi 121).

203. Në këtë kuptim, Gjykata sërish thekson që mënyra e votimit të Nënkyetarëve të Kuvendit, në pako apo veç e veç, mbetet në vullnetin e deputetëve, me kushtin që mënyra e propozuar e votimit të Nënkyetarëve ti nënshtrohet procedurës së votimit nga shumica e deputetëve të zgjedhur të Kuvendit. Si rrjedhojë, Gjykata konsideron se propozimi i votuar për votimin e nënkryetarëve të Kuvendit veç e veç nuk është në kundërshtim me nenin 67 të Kushtetutës.
204. Si rrjedhojë, Gjykata, në kontekst të procedurës së zgjedhjes së Nënkyetarëve të Kuvendit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje!, LDK-së, Listës Serbe dhe komuniteteve të tjera joshumicë, vëren që pas miratimit të propozimit për votimin veç e veç, përmes Vendimit [nr. 11-V-003] të 11 shtatorit 2026 dhe Vendimeve [nr. 11-V-004; nr. 11-V-005; nr. 11-V-004; dhe nr. 11-V-006] të 13 shtatorit 2026, ishin zgjedhur katër (4) nënkryetarët e Kuvendit.
205. Megjithatë, Gjykata vëren që më 11 shtator 2026 propozimi i grupit të dytë më të madh parlamentar për kandidatin për Nënkyetar të Kuvendit nuk kaloi pasi mori dyzet e katër (44) vota për, një (1) kundër dhe pesëdhjetë e gjashtë (56) abstenime. Gjykata, bazuar në transkriptin e seancës së 13 shtatorit 2026, vëren se Kryetarja e Kuvendit kishte theksuar se përkundër thirrjeve për propozim të nënkryetarit nga PDK dhe njoftimit për vazhdimin e Seancës Konstituive drejtuar PDK-së, kjo e fundit nuk mori pjesë në vazhdimin e Seancës Konstituive dhe nuk ushtroi të drejtën e saj kushtetuese.
206. Po ashtu nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se më 13 shtator 2026, PDK-ja njoftoi Kryetaren e Kuvendit për *“tërheqjen e përkohshme të kandidaturës së znj. Vlora Çitaku”* për pozitën e nënkryetares, duke bërë të ditur se do t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin dhe sqarimin e situatës së krijuar.
207. Gjykata rikujton se neni 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] i Kushtetutës i përmban 8 paragrafë që përcaktojnë zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë, përkatësisht, Kryetarin dhe Nënkyetarët, si dhe rolin dhe mënyrën e funksionimit të Kryesisë së Kuvendit. Më konkretisht, paragrafët 1 dhe 6 të këtij neni përcaktojnë se Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe 5 (pesë) Nënkyetarë, të cilët përbëjnë Kryesinë e Kuvendit, që është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit. Paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës përcaktojnë se: (i) Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar; (ii) 3 (tre) nënkryetarë propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare; dhe (iii) 2 (dy) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend, përkatësisht komunitetin Serb dhe komunitet e tjera. Kryetari dhe nënkryetarët zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit (shih, rastin e Gjykatës [KO325/25](#), cituar më lart, paragrafin 107).
208. Gjykata rikujton se përmes Aktgjykimit në rastin KO265/25, është sqaruar se në rastet kur e drejta kushtetuese në procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit gjatë konstituimit të Kuvendit nuk ushtrohet nga deputetët apo grupet parlamentare, që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, qofshin ato nga komuniteti shumicë apo nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, të cilat mund të manifestohen në pengimin e këtij procesi, apo në rastet kur, përkundër vullnetit të shumicës së deputetëve për të zgjedhur anëtarin e Kryesisë, Kuvendi i pamundësohet zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së saj, Kuvendi përjashtimisht, do të mund të vazhdojë funksionimin edhe pa njërin nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, me kushtin që Kryesia e Kuvendit të ketë kuorum në vendimmarrjen e saj në përputhje me paragrafin 3 të nenit 20 (Mbledhja e

Kryesisë) të Rregullores së Kuvendit (shih, rastin e Gjykatës [KO265/25](#), cituar më lart, paragrafi 148). Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, nga shkresat e lëndës rezulton se PDK nuk ka refuzuar ushtrimin e të drejtës së propozimit të kandidatit për nënkryetar të Kuvendit por përkohësisht e ka tërhequr kandidaturën e saj deri në një vendim të Gjykatës.

209. Gjykata duke u bazuar në Transkriptin e seancave të 11 dhe 13 shtatorit 2026, si dhe njoftimin e PDK-së për “*tërheqje të përkohshme*” të kandidaturës së kandidates së propozuar për Nënkryetare të Kuvendit vëren se “*tërheqja e përkohshme*” nuk përbën heqje dorë nga e drejta e tyre e propozimit dhe për pasojë Gjykata konsideron që e drejta për të propozuar dhe zgjedhur Nënkryetaren nga radhët e grupit të dytë më të madh parlamentar nuk ishte konsumuar.
210. Rrjedhimisht, në kuptim të së drejtës së grupit të dytë më të madh parlamentar për përfaqësim në Kryesinë e Kuvendit, Gjykata konstaton që deputetët Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet që sa më parë të zgjedhin Nënkryetarin nga radhët e grupit të dytë më të madh parlamentar në pajtim me paragrafin 3 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës.

III. Lidhur me pretendimet për zgjedhjen e Qeverisë

A. Pretendimet e parashtruesve të kërkesave

211. Parashtruesit e kërkesës KO258/26 pretendojnë se “*Vendimi Nr. 11-V-007, i 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës*” nuk është në përputhje me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 4, 16, 66, 67, 74 dhe 92 të Kushtetutës, për shkak se është miratuar nga një legjislaturë e cila nuk kishte përfunduar konstituimin në pajtim me kërkesat kushtetuese.
212. Ky pretendim i parashtruesve të kërkesave mbështetet nga deputeti z. Burim Ramadani, i cili përmes komenteve të dorëzuara ka theksuar se Vendimi i 13 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Qeverisë është nxjerrë nga një Kuvend që nuk është i konstituuar; ndërsa kundërshtohet nga Kryetarja e Kuvendit, grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje! dhe Grupi Multietnik.

B. Vlerësimi i Gjykatës

213. Gjykata marrë për bazë konstatimin se Kuvendi është konstituuar pas kalimit të afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës, do të vijojë me vlerësimin e asaj nëse Vendimi [Nr. 11-V-007] i Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë është në pajtueshmëri me nenin 95 të Kushtetutës.
214. Gjykata u referohet paragrafëve 1 deri 3 të nenit 95 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë që:
- “1. Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.
 2. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.
 3. Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. [...]”

215. Gjykata vëren se në mënyrë që Qeveria të zgjidhet, sipas paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, “për” Qeverinë duhet të votojnë të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetë të Kuvendit.
216. Gjykata rikujton që më 13 shtator 2026, U.d. Presidentja, përmes Dekretit [nr. 169/2026] për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë, e propozoi z. Albin Kurti kandidat për Kryeministër për të formuar Qeverinë. Në të njëjtën ditë, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! iu drejtuan Kryetares së zgjedhur të Kuvendit me kërkesë për thirrjen e Seancës së Jashtëzakonshme të Kuvendit për 13 shtator 2026 për zgjedhjen e Qeverisë. Të njëjtën ditë, Kuvendi, përmes Vendimit [Nr. 11-V-007] zgjodhi Qeverinë.
217. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që Vendimi [Nr. 11-V-007] i Kuvendit i 13 shtatorit 2026 për zgjedhjen e Qeverisë është nxjerrë brenda afateve të përcaktuar me nënparagrafin 1 të paragrafit 1 të nenit 82 dhe në përputhshmëri me nenin 95 të Kushtetutës.

IV. Vlerësimi dhe konstatimi i Gjykatës lidhur me rrjedhjen e afatit për zgjedhjen e Presidentit

218. Në vijim dhe duke marrë për bazë rëndësinë e funksionit të Presidentit të përcaktuar me Kushtetutë, Gjykata nënvizon se procesi i zgjedhjes së Presidentit, ka peshë të veçantë për rendin kushtetues dhe përbën një moment shumë të rëndësishëm në jetën politike, institucionale dhe shtetërore të Republikës së Kosovës. Kjo për faktin që Kushtetuta përcakton që Presidenti mishëron unitetin e popullit, përfaqëson shtetin brenda dhe jashtë, si dhe garanton funksionimin demokratik të institucioneve (shih, rastet e Gjykatës [KO72/26 dhe KO74/26](#), cituar më lart, paragrafi 173).
219. Gjykata rikujton se në rastet KO72/26 dhe KO74/26 ka trajtuar ndërveprimin ndërmjet afatit gjashtëdhjetë (60) ditor të përcaktuar me nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës dhe afatit të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata ka sqaruar se nga këto dispozita, të lexuara së bashku, rezulton, ndër të tjera, se Kuvendi shpërndahet *ex constitutione* nëse brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga fillimi i procedurës nuk arrin të zgjedhë Presidentin, si dhe se Kuvendi ka të drejtë të ketë në dispozicion periudhën gjashtëdhjetë (60) ditore për zhvillimin e kësaj procedure (shih, rastet KO72/26 dhe KO74/26, cituar më lart, paragrafët 150-152).
220. Përkitazi me rrethanat në të cilat procedura për zgjedhjen e Presidentit duhet të zhvillohet nga një legjislaturë e re, Gjykata në KO72/26 dhe KO74/26 ka trajtuar në mënyrë specifike situatën kur nuk ka Kuvend të konstituuar dhe funksional. Gjykata, duke iu referuar edhe Aktgjykimit KO124/25, ritheksoi se Seanca Konstituive është akt kushtetues që duhet të përmbushet me sukses brenda tridhjetë (30) ditëve nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve, “përmes përmbushjes së të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit të Kuvendit”. Mbi këtë bazë, Gjykata përcaktoi se, në rrethanat e një Kuvendi ende të pakonstituuar, procedura për zgjedhjen e Presidentit duhet të fillojë nga dita e konstituimit të Kuvendit dhe të përfundojë më së largu brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fillimi i saj (shih rastet KO72/26 dhe KO74/26, cituar më lart, paragrafët 161-162).
221. Në vijim, si rrjedhojë e konstatimit të Gjykatës që afati për konstituimin e Kuvendit ka përfunduar më 7 gusht 2026 dhe se kalimi i këtij afati detyrues ka për pasojë fillimin e rrjedhjes së afateve tjera kushtetuese, Gjykata konstaton që afati për zgjedhjen e Presidentit, në rrethanat e rastit konkret ka filluar të rrjedhë më 8 gusht 2026.

222. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se Kushtetuta u ka dhënë deputetëve gjithë hapësirën e nevojshme që në kuadër të garancive të mandatit jodetyrues dhe kërkesave për të ushtruar mandatin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës, të gjejnë mënyrën për t'i dhënë shtetit Presidentin e ri, ndërsa popullit përfaqësuesin dhe simbolin e unitetit, në përputhje me procedurën e përcaktuar me Kushtetutë dhe të sqaruar më tej në praktikën gjyqësore (shih, rastet e Gjykatës: [KO29/11](#), parashtrues *Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë*, Aktgjykim, i 28 marsit 2011; dhe [KO47/16](#), parashtrues *Aida Dërguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 2016).
223. Në kontekstin specifik të rrethanave të një Kuvendi të shpërndarë dhe ende të pa konstituuar, Gjykata bazuar në interpretimin si më lart dhe qëllimin e normave kushtetuese, të përcaktuara përmes nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 ndërlidhur me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, rithekson se procedura për zgjedhjen e Presidentit duhet të fillojë nga dita e konstituimit të Kuvendit dhe të përfundojë më së largu brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit. Megjithatë, bazuar në elaborimin si më sipër dhe në kontekst të rrethanave të rastit, (i) ndërlidhur me afatin e përcaktuar kushtetues të zgjedhjes së Presidentit kur nuk ka Kuvend të konstituuar dhe funksional; dhe (ii) duke iu referuar qëllimit të normave kushtetuese të përcaktuara përmes nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 në lidhje me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se procedura për zgjedhjen e Presidentit duhet të fillojë nga dita e konstituimit të Kuvendit dhe të përfundojë më së largu brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit. Për pasojë, duke marrë parasysh se procesi i konstituimit të Kuvendit duhej të ishte përfunduar më së largu më 7 gusht 2026, Gjykata vlerëson se afati gjashtëdhjetë (60) ditor për zgjedhjen e Presidentit, sipas nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82, në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, ka filluar të rrjedhë më 8 gusht 2026.
224. Si rezultat i konstatimit si më sipër që afati gjashtëdhjetë (60) ditor për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës ka filluar më 8 gusht 2026, Gjykata konstaton se ky afat përfundon më 6 tetor 2026. Prandaj, duke marrë për bazë domosdoshmërinë e funksionimit të institucioneve kushtetuese, përkatësisht vazhdimin e funksionimit të institucionit të Presidentit, me mandat dhe pushtet të plotë kushtetues, Gjykata konsideron që Kuvendi deri më 6 tetor 2026 duhet zhvilluar dhe përfunduar procedura për zgjedhjen e Presidentit.
225. Gjykata sërish rithekson rëndësinë e asaj se deputetët brenda këtij afati të përcaktuar nga Gjykata duhet të shfrytëzojnë në mënyrë racionale kohën të cilën Kushtetuta u ka vënë në dispozicion për të përmbushur një nga obligimet themelore kushtetuese, atë të zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës. Gjykata tashmë ka vlerësuar se kjo e drejtë e deputetëve buron nga Kushtetuta dhe është në përputhje me funksionin dhe vullnetin e popullit për t'i besuar deputetit zgjedhjen e Presidentit të shtetit (shih, rastet e Gjykatës [KO72/26](#) dhe [KO74/26](#), cituar më lart, paragrafi 178).
226. Në fund, Gjykata rithekson që në rast se pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, përmes të cilit përcaktohet që Kuvendi deri më 6 tetor 2026 duhet të vazhdojë dhe të përfundojë zgjedhjen e Presidentit, Kuvendi dështon të zgjedhë Presidentin/en e ri/re, Kuvendi, bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës shpërndahet *ex constitutione*, dhe për pasojë, zgjedhjet e parakohshme për Kuvend duhet të zhvillohen brenda dyzet e pesë (45) ditësh, pas ditës së shpërndarjes së Kuvendit, ashtu siç

përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe paragrafit 6 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

227. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës në rastin KO256/26 po ashtu kërkojnë nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht kërkojnë që të pezullohen *“efektet juridike që varen nga konstatimi i kontestuar i konstituimit, përfshirë rrjedhjen dhe zhvillimin e procedurës kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit, deri në vendimin përfundimtar”*.
228. Në këtë kontekst, marrë parasysh që Gjykata tashmë ka vendosur lidhur me kërkesën e parashtruesve të kërkesave, Gjykata thekson se është i panevojshëm shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për masë të përkohshme (shih, rastin e Gjykatës KI207/19, parashtrues *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 237; dhe shih gjithashtu rastin [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 193).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullat 48 (1) (a) dhe (d) dhe 72 të Rregullores së punës, më 23 shtator 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË që Kuvendi i Republikës së Kosovës është konstituuar pas kalimit të afatit tridhjetë (30) ditor, të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË KONSTATOJË që kalimi i afatit tridhjetë (30) ditor për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka për pasojë fillimin e rrjedhjes së afateve kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, kur posti i Presidentit është vakant dhe për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas neneve 86 [Zgjedhja e Presidentit], 95 [Zgjedhja e Qeverisë] dhe nënparagrafëve 1 dhe 3, paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- IV. TË KONSTATOJË që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet që sa më parë të zgjedhin Nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e grupit të dytë më të madh parlamentar, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË që Vendimi [Nr. 11-V-007] i 13 shtatorit 2026 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk është në kundërshtim me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

- VI. TË KONSTATOJË që afati gjashtëdhjetë (60) ditor për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, sipas nënparagrafit 3, paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka filluar më 8 gusht 2026 dhe përfundon më 6 tetor 2026;
- VII. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- IX. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- X. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Gjyqtarja raportuese

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Remzije Istrefi-Peci

Nexhmi Rexhepi